**ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT**

*Sipas Nenit 109 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës se Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092*

Për: **AGJENCIA PER MENAGJIM EMERGJENT**

| **Nr1 i prokurimit** | 21432700-25-3692-1-1-1 |
|---|---|
| | |

**Titulli:Furnizim me pasije te ndryshme për zjarrfikje dhe shpëtim**

**LOT 2 Furnizim me pajisje intervenuese për shpëtim në situata emergjente**

## ANKESË

1. **Identifikimi i ankuesit**

**Grupi i OE Komtel Project Engineering SH.P.K. & BAJRA N.P.T.**

*(Shëno emrin e plotë të kompanisë suaj)*

*Rr. Agim Ramadani Prishtine / Lagja Marigona, Preoc*

*(Adresa)*

*Prishtine / Gracanice* — *10000/10500*

*(Vendi)* — *(Kodi postar)*

*+38338224545 / +38344327000*

*(Numri Telefonit)* — *(Numri i Faks-it)*

*Vegim Gashi / Nehat Raifi*

*(Emri i plotë i përfaqësuesit të kompan isë suaj)*

vegim@komtelpe.com / bajranpt@gmail.com

*22.06.2026*

*(Data e parashtrimit të kërkesës)*

*(Nënshkrimi dhe vula)*

[1] Të raportohet në çdo dokument apo kërkesë në lidhje me këtë aktivitet të prokurimit

## 2. Identifikimi i avokatit

*Parashtruesi i kërkesës mund ta parashtroj kërkesën vetëm ose përmes avokatit të tij. Nëse kërkesa parashtrohet përmes avokatit, atëherë duhet bashkangjitur autorizimin e përfaqësimit me PROKURË.*

*Shëno të dhënat si në vijim:*

________________________________________________________________________
*(Emri i avokatit)*

________________________________________________________________________
*(Adresa e plotë)*

_________________________________ ___________________________________
*(Numri i Telefonit)* *(Numri i faks-it)*

_________________________________
*(Adresa elektronike)*

________________________________ _________________________________
*(Data e parashtrimit të kërkesës)* *(Nënshkrimi dhe vula)*

## 3. Të dhënat mbi aktivitetin e prokurimit

*[Shëno një përshkrim te shkurtër lidhur me datën dhe vendin në të cilën është publikuar " Njoftimi për Kontratë" apo "Njoftimi për konkurs te projektimit" dhe, nëse aplikohet "Njoftimi për dhënie të Kontratës","Njoftimi për Rezultatet e Konkursit të Projektimit" apo "Njoftimi për anulim te aktivitetit te prokurimit", nëse aplikohet, afatin e fundit për dorëzimin e tenderit, datën dhe orën e fillimit të procesit për Hapjen e Tenderëve, si dhe kriteri për dhënie të kontratës]:*

B05 Njoftim per Kontrat
15.10.2025 11:31
B54 Formulari standard per korrigjimin e gabimeve ne njoftimet e publikuara
03.11.2025 15:48
B54 Formulari standard per korrigjimin e gabimeve ne njoftimet e publikuara
21.11.2025 10:00
B54 Formulari standard per korrigjimin e gabimeve ne njoftimet e publikuara
27.11.2025 13:59
B54 Formulari standard per korrigjimin e gabimeve ne njoftimet e publikuara
05.12.2025 16:45
B54 Formulari standard per korrigjimin e gabimeve ne njoftimet e publikuara
25.02.2026 13:50
B54 Formulari standard per korrigjimin e gabimeve ne njoftimet e publikuara
04.03.2026 12:27

B54 Formulari standard per korrigjimin e gabimeve ne njoftimet e publikuara
28.04.2026 21:27
Njoftimi paraprak
29.04.2025 21:52
Dosja e Tenderit
DOSJA E TENDERIT SHQIP , Versioni i Korigjuar 25.02.2026.Docx25.02.2026 13:46
25.02.2026 13:48 LOT 2, SPEC. TKENIK i KORIGJUAR 25.06.2025 (shqip, anglisht dhe serbisht).docx4
03.11.2025 15:47 Njoftim 03.11.2025.pdf
06.11.2025 10:18 Vendim Eng Bau ShPK,03.11.2025.pdf
06.11.2025 10:18 Vendim DESIGN PROJECT TECHNOLOGY SHPK,03,11.2025.pdf
07.11.2025 11:18 Njoftim per pezullim 07.11.2025.pdf
10.11.2025 10:34 Vendim BAJRA NPT 10.11.2025.pdf
18.11.2025 11:27 Njoftim per pezullim 18.11.2025.pdf
21.11.2025 10:01 Njoftim per shtyerje te afateve per pergjegjien ndaj KSH 21.11.2025.pdf
25.11.2025 13:47 Vendim NIKA Pro - Ing SHPK.pdf
27.11.2025 10:00 Vendim MS.NTSH Medicom SHPK.pdf
02.12.2025 14:59 Njoftim per sqarime ne specifikim teknik 2.12.2025.pdf
05.12.2025 16:49 Njoftim 05.12.2025.pdf
08.12.2025 13:42 Vendim Safety 1st L.L.C. 8.12.2025.pdf
04.03.2026 12:27 Vendim , ALBKOS SAFETY SH.P.K 04.03.2026.pdf
Kerkese per Informacione Shtese AME.pdf06.03.2026 14:5
16.03.2026 08:39 Njoftim per pezullim 16.03.2026.pdf
04.06.2026 15:16 Njoftim mbi vendimin e AK dhe letrat standarde.pdf
Lista e çmimeve LOT 2, Furnizim me pajisje intervenuese për shpëtim në situata emergjente.xlsx15.10.2025
B08 Njoftim për dhënie të kontratës
08.06.2026 11:38
B10 Njoftimi per anulimin e aktivitetit te prokurimit
08.06.2026 11:44
Vendimi i AK në Kërkesën për rishqyrtim
Vendim Eng Bau ShPK.pdf03.11.2025 15:33
Vendimi i AK në Kërkesën për rishqyrtim
Vendim DESIGN PROJECT TECHNOLOGY SHPK.pdf03.11.2025 15:35
Vendimi i AK në Kërkesën për rishqyrtim
Vendim BAJRA NPT 10.11.2025.pdf10.11.2025 10:30
Vendimi i AK në Kërkesën për rishqyrtim
Vendim NIKA Pro - Ing SHPK.pdf25.11.2025 13:45
Vendimi i AK në Kërkesën për rishqyrtim
Vendim MS.NTSH Medicom SHPK.pdf27.11.2025 09:56
Vendimi i AK në Kërkesën për rishqyrtim
Vendim ALBKOS SAFETY SHPK 08.12.2025.pdf08.12.2025 13:39
Vendimi i AK në Kërkesën për rishqyrtim
Vendim Safety 1st L.L.C. 8.12.2025.pdf08.12.2025 13:42
Vendimi i AK në Kërkesën për rishqyrtim
Vendim , ALBKOS SAFETY SH.P.K 04.03.2026.pdf04.03.2026 12:29
Kerkese per qasje ne dokumentacion.pdf04.06.2026 15:51
B58 Njoftim mbi vendimin e autoriteti kontraktues
Njoftim mbi vendimin e AK dhe letrat standarde.pdf04.06.2026 15:15
B12 Proces verbali i hapjes se Tenderve
Kërkesë për rishqyrtim - Kerkese per Rishqyrtim ne Njoftimin mbi Vendimin e dates 04.06.2026
09.06.2026 14:35
Vendimi i AK në Kërkesën për rishqyrtim
Vendim - Komtel Project SHPK - 11.06.2026.pdf
11.06.2026 13:48

**4. Procesi i Hapjes së tenderëve,** *nëse aplikohet*

*A keni marrë pjesë në procesin e Hapjes së tenderëve? Nëse po, specifikoni shkurtimisht ecurinë e procesit të Hapjes së Tenderëve.*

**Po** ☐ **Jo** JO

**5. Njoftimi mbi Eliminimin e Tenderuesve,** *nëse aplikohet*

*A jeni njoftuar me shkrim lidhur me eliminimin tuaj nga pjesëmarrja e mëtutjeshme në aktivitetin e prokurimit ?*

**Po** PO **Jo** ☐

**6. Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues**

*Specifikoni dispozitën ose dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga Autoriteti Kontraktues që nga momenti i publikimit të Njoftimit për Kontratë/Konkurs te Projektimit, dhe nëse aplikohet gjerë në përmbylljen e këtij aktiviteti të prokurimit me publikimin e Njoftimit për Dhënien e Kontratës apo Njoftimit për Rezultatet e Konkursit të Projektimit apo Njoftimit për Anulim.*

Neni 1. Qëllimi
Neni 7. Barazia në Trajtim/ Jo-Diskriminimi
Neni 6. Ekonomiciteti dhe Efikasiteti
Neni 66 Përshtatshmëria Profesionale
Neni 69 Aftësia Teknike dhe/ose Profesionale
Neni 28. Specifikimet teknike
Udhezim 001/2023
Neni 70. Standardet për Sigurimin e Cilësisë
Neni 59 Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahasimi i Tenderëve

**7. Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet**

*Përshkruani rrethanat faktike që përbëjnë supozimin për shkeljen e dispozitave të LPP-së. Ofroni deklaratë të qartë dhe të detajuar për faktet dhe argumentet të cilat mbështesin secilën bazë të kërkesës suaj për rishqyrtim.*

Të nderuar,

Bazuar në Ligjin Nr. 04/L-042 për Prokurim Publik në Republikën e Kosovës i ndryshuar dhe plotësuar me Lgjin Nr. 04/L-237, Ligjin Nr. 05/L-068 dhe Ligjin Nr. 05/L-092 Udhezimin dhe rregulloren e prokurimit publik, konsiderojmë që në njoftimin mbi vendimin e autoriteti kotnraktues janë shkelur dispozita ligjore të këtij ligji.
Neni 1 Qëllimi Ne konstatojmë që kjo dispozitë e LPP është shkelur pasi Autoriteti Kontraktues – nuk ka trajtuar në parim RROUPP, 001/2023 dhe LLP sipas nenit 1. Neni 7 i LPP-së Barazia në Trajtim/ Jo-Diskriminimi - Ne si operator ekonomik konstatojmë që kjo dispozitë e LLP-së është shkelur nga Autoriteti Kontraktues i cili nuk ka trajtuar në parim RRUOPP dhe LLP-në. Autoriteti Kontraktues do t'i trajtoj operatorët ekonomik në mënyrë të barabartë dhe jodiskriminuese dhe do të veprojë në mënyrë transparente. 1. Autoriteti Kontraktues nuk do të ekzekutojë asnjë aspekt të aktivitetit të prokurimit në një mënyrë që redukton apo eliminon konkurrencën në mes të operatorëve ekonomik ose që diskriminon në dëm ose në të mirë te një ose më shume operatoreve ekonomik. Autoritetit kontraktues posaçërisht i ndalohet që të përcaktojë nevojat e veta që duhet të përmbushen, specifikojë lëndën që do të prokurohet, ndajë ose përmbledh sasitë ose artikujt e tjerë që duhet të prokurohen, duke zgjedhur një procedurë të prokurimit, ose duke vendosur një kërkesë ose kriter të përzgjedhjes ose specifikacion teknik që në ndonjë mënyrë ka për qëllim të favorizojë ose diskriminojë kundër njërit ose më shumë operatorëve ekonomik. Gjatë udhëheqjes së aktiviteteve të prokurimit, të gjitha autoritetet kontraktuese duhet të sigurojnë pjesëmarrje sa më të gjerë të mundshme të operatorëve të interesuar ekonomik si dhe duhet të sigurojnë eliminimin e praktikave, kritereve, kërkesave dhe specifikimeve teknike që diskriminojnë në favor ose kundër një ose më shumë operatorëve ekonomik. Prandaj, ne si OE te interesuar per kete aktivitet kemi vleresuar se me vendimin e dhene eshte favorizuar operator ekonomik plotsisht i papërgjegjshem

Ne, si operator ekonomik pjesëmarrës në këtë aktivitet të prokurimit nuk pajtohemi me vendimin e ketij aktiviteti, në këtë pikë shohim të jetë shkelur edhe Neni 7. Barazia në Trajtim/ Jo-Diskriminimi
Autoriteti Kontraktues, duhet të ketë për qëllim që me mjetet e planifikuara monetare, të furnizohet me materiale / produkte cilësore me jetëgjatësi të gjatë, e të cilat gjithashtu do të plotësonin të gjitha standardet e kualitetit, standardet e sigurisë, standardet e ndotjes së ambientit, etj dhe bazuar në këtë duhet të bëjë hartimin e drejt te specifikave ndërsa në mënyrën se si është vepruar shohim që nuk i është dhënë aspak rëndësi qëllimit të aktivitetit dhe aspak rëndësi hapje se konkurrences apo barazise por ka favorizuar diskriminimin- Neni 6 Ekonomiciteti dhe Efikasiteti 1. Të gjitha autoritetet kontraktuese, janë të obliguara që të sigurojnë që fondet publike dhe burimet publike të përdoren në mënyrën më ekonomike, njëkohësisht duke marrë në konsideratë qëllimin dhe lëndën e prokurimit. Është cekur shumë qartë kërkesa për cdo kriter të vendosur ndërkohë që AK ka shkelur kriteret e përcaktuara nga vet si autoritet.

**Pretendimi Ankimor Nr. 1. Njoftimi mbi Vendimin – Tenderues të eliminuar / papërgjegjshëm Grupi OE Komtel Project Engineering SHPK & BAJRA NPT**

Më datë 04 qeshor '26 kemi pranuar njoftimin mbi vendimin nga i cili vendim jemi njoftuar që për kontratë është rekomanduar OE i papërgjegjshëm gjë të cilën e kemi konstatuar pas qasjes në dokumentacionin e ofertës.

Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria – Vlada - Government
*Ministria e Punëve të Brendshme /Ministarstvo Unutrašnjih Poslova/*
*Ministri of Internal Affairs*
Agjencia e Menaxhimit Emergjent/Agencija o Upravljanju Vanrednim Situacijama /
Agency of Emergency Management

**NJOFTIM MBI VENDIMIN E AUTORITETIT KONTRAKTUES**
*Sipas Nenit 43.7 dhe 44.2 të Rregullave dhe Udhëzuesit Operativ te Prokurimit Publik*

**Titulli i kontratës i dhënë nga autoriteti kontraktues: Furnizim me pajisje te ndryshme për zjarrfikje dhe shpëtim**
**LOT 1 Furnizim me kompresor, varaka dhe pajisje tjera mbështetëse.**
**LOT 2 Furnizim me pajisje intervenuese për shpëtim në situata emergjente**
**LOT 3 Furnizim me pajisje te ndryshme profesionale zjarrfikëse**
**LOT 4 Furnizim me mjete dhe pajisje shpëtimi në aksidente dhe fatkeqësi dhe pajisje stacionare**
**LOT 5 Furnizim me pajisje pune dhe ndihmëse për zjarrfikës**
**LOT 6 Furnizim me Ekstrakt Shkume 100% Biologjik dhe Ekologjik**

**Numri i aktivitetit te prokurimit:**

| Nr. i prokurimit[1] | 21432700-25-3692-1-1-1 |
|---|---|

**LOT 1: Furnizim me kompresor, varaka dhe pajisje tjera mbështetëse.**

| Nr. | Emri dhe adresa e Operatorit Ekonomik | Vlera totale e ofertës |
|---|---|---|
| 1. | N.T.SH."M.S.MEDICOM ", , MAJOR MEHMET BUSHI, 10000, PRISHTINË | 475,006.64 € |

Agjencia e Menaxhimit Emergjent – AME, **shpërblen** me kontratë „ N.T.SH."M.S.MEDICOM ", , MAJOR MEHMET BUSHI, 10000, PRISHTINË **për LOT 1,** ne vlere totale te ofertës 475,006.64 €,

**LOT 2: Furnizim me pajisje intervenuese për shpëtim në situata emergjente**

| Nr. | Emri dhe adresa e Operatorit Ekonomik | Vlera totale e ofertës |
|---|---|---|
| 1. | RUNWAY SH.P.K., Rr.Luan Haradinaj, Pallati i Rinisë Nr.30, 10,000, Prishtine | 581,495.12 € |
| 2. | Grup i Operatorëve Ekonomik Komtel Project Engineering SH.P.K.; N.P.T. Bajra, Agim Ramadani 34/7, 10000, PRISHTINË | 769,333.33 € |

Agjencia e Menaxhimit Emergjent – AME, **shpërblen** me kontratë RUNWAY SH.P.K., Rr.Luan Haradinaj, Pallati i Rinisë Nr.30, 10,000, Prishtine **për LOT 2,** ne vlere totale te ofertës 581,495.12 Euro.

**Fillimisht, AK ka vepruar në kundërshtim me ligjin e prokurimit publik duke dhënë njoftimin mbi vendimin për Grupin e operatorëve Komtel Project Engineering SH.P.K. & Bajra N.P.T. "Te eliminuar" administrativisht të papërgjegjshëm . Në vijim arsyetimi i dhënë:**

*Arsyetim*

Në Aneksin e Specifikimit teknik te LOT 2 tek artikulli nr. 1
**SHARRE RRETHORE PER PRERJE TE METALIT ME BATERI**

**Është kërkuar:**
Sharre rrethore profesionale per zjarrfikes per pune te renda dhe nderhyrje emergjente me doreze mbajtese ergonomike dhe shkalle te mbrojtjes IPX4, Disku 12" (300mm/3.5mm/20mm), Per pune ne temperatura Bateria -10°C deri ne min 40°C ,
**Tensioni nominal 45-80 V**
Konsumi i energjisë 3-5 kW,

Në katalogun tuaj te prezantuar ne ofertë gjate vlerësimit, krahasimit dhe ekzaminimit mbështetur ne LPP Nenin 59 dhe Specifikimin teknik te LOT 2 komisioni vlerësues konstaton se nuk plotësoni kërkesat për këtë artikull pasi ne katalogun tuaj është si vijon:

**Tensioni nominal ne katalogun tuaj është 35 v** që d.m.th. është nën kërkesën e kërkuar




**19.1 STIHL TSA 500.0-B Cut-off machine**
– Approved batteries:
– STIHL AP 300, 300 S, 500 S
– Weight without battery and cutting wheel: 9.1 kg
– Max. pressure of water supply: 4 bar
– Degree of protection: IPX4 (protection against splash water from any direction)

**19.2 STIHL AP Battery**
– Battery technology: Lithium-ion
– Voltage: 36 V
– Capacity in Ah: see rating label
– Energy content in Wh: see rating label
– Weight in kg: See rating label
– Bluetooth® radio interface (only for batteries with Ⓖ):

**20.1 Cutting wheels for STIHL TSA 500.0-B**
The specified maximum permitted operating speed of the cutting wheel must be greater than or equal to the maximum spindle speed of the cut-off machine used.
– Maximum spindle speed: 5020 rpm
– Outside diameter: 350 mm
– Hole diameter or spindle diameter: 20 mm
– Tightening torque: 30 Nm.

The specified maximum permitted operating speed of the cutting wheel must be greater than or equal to the maximum spindle speed of the cut-off machine used.
– Maximum spindle speed: 6080 rpm
– Outside diameter: 300 mm
– Maximum thickness: 3.5 mm

Në Aneksin e Specifikimit teknik te LOT 2 tek artikulli nr. 2
**MOTORSHARRE PER PRERJE LLAMARINE**

**Është kërkuar:**
Sharre shpetimi profesionale per zjarrfikes me një dorezë të madhe shtesë që e bën më të lehtë ndezjen me doreza, një dorezë tjetër për rregullim të shpejtë dhe të lehtë të thellësisë së prerjes, një kufizues të thellësisë së prerjes për ekzekutimin e prerjeve të kontrolluara me kanale,
**Fuqia e motorit 4.1-4.4kW (raporti fuqi peshe 1,4kg-1,5kg/kw)\70-71,9 cm ³ , 13,000-13,350rpm / shpejtesi 10.000 min-1**

Në katalogun tuaj te prezantuar ne ofertë gjate vlerësimit, krahasimit dhe ekzaminimit mbështetur ne LPP Nenin 59 dhe Specifikimin teknik te LOT 2 komisioni vlerësues konstaton se nuk plotësoni kërkesat për këtë artikull pasi ne katalogun tuaj është si vijon:

Ne Aneksin e **specifikimit teknik është kërkuar 13,000 – 13,350 rpm**, kurse ne katalogun e **prezantuar ne ofertë nga ana juaj është 13,500 rpm mbi nivelin e kërkesës se AK-së.**

Po ashtu është kërkuar 70 – 71.9 $cm^3$ kurse ne katalogun e ofertës se prezantuar nga ana juaj është 72.2 $cm^3$· që dmth është mbi nivelin e kërkesës se AK-së

Power to weight ratio 1.50 kg/kW
Maximum engine speed: 13,500 rpm ± 200

**STIHL MS 462 C-M R Chainsaw**
- Displacement: 72.2 cm³
- Engine power to ISO 7293: 4.4 kW (6 bhp)
- Idle speed according to ISO 11681: 2800 ± 50 rpm
- Approved spark plug: NGK CMR6H from STIHL
- Electrode gap of the spark plug: 0.5 mm
- Dry weight without guide bar and saw chain 6.5 kg
- Max. fuel tank capacity: 720 cc (0.72 l)
- Max. oil tank capacity: 340 cm³ (0.34 l)

**Chain Sprockets and Chain Speeds**
The following chain sprockets may be used:
- 7-tooth for 3/8"
  - Maximum chain speed according to ISO 11681: 28.9 m/s
  - Chain speed at maximum power: 21.7 m/s

**Minimum Groove Depth of Guide Bars**
The minimum groove depth depends on the pitch of the guide bar.
- 3/8": 6 mm

**Sound Values and Vibration Values**
- Sound pressure level $L_{peq}$ measured according to ISO 22868: 105 dB(A). The K value for the sound pressure level is 2 dB(A).
- Sound power level $L_{weq}$ measured according to ISO 22868: 118 dB(A). The K value for the sound power level is 2 dB(A).
- Vibration level $a_{hv}$ measured according to ISO 22867:
  - Handlebar: 3.3 m/s². The K value for the vibration level is 2 m/s².
  - Control handle: 2.7 m/s². The K value for the vibration level is 2 m/s².

**STIHL MS 462 C-M R Chainsaw**
The following guide bars and saw chains may be mounted:
- Guide bar: Rollomatic Super
  - Pitch: 3/8"
  - Groove width: 1.6 mm
  - Length: 50 cm
  - Number of nose sprocket teeth: 11
- Chain: 36 RDR (Type 3944)
  - Pitch: 3/8"
  - Drive link gauge: 1.6 mm
  - Number of drive links: 72




***Mbështetur me te gjitha këto fakte dhe argumente ligjore te prezantuara si me lart komisioni vendos qe te eliminoj ofertën tuaj si te pa përgjegjshme***

Nëse besoni se Autoriteti Kontraktues, gjatë procedurës së prokurimit publik, ka shkelur LPP apo rregullat e zbatueshme, ju keni të drejtë te parashtroni ankese pranë Autoritetit Kontraktues, në bazë të nenit 108/A të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës se Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092.
Edhe nëse nuk kemi qene në gjendje t'i përdorim shërbimet tuaja kësaj here, besojmë se do të vazhdoni të shfaqni interesim për nismat tona të ardhshme të prokurimit.

Me respekt,

______________________, ______________________
*(Emri dhe Mbiemri i Zyrtarit të Prokurimit)* *(Nënshkrimi)*

**Arsyetimet e dhënë në njoftimin mbi vendimin janë në kundërshtim me natyrën e aktivitetit dhe ligjin e prokurimit publik.**

1. Për pozicionin Nr.1. Sharrë rrethore për prerje të metalit me bateri ne si grup i OE kemi ofertuar modelin TSA 500 të prodhuesit Stihl i cili është në përputhshmëri të plotë me kërkesat e dosjes së tenderit – Aneksi 1 Specifikimet teknike te detyrushme.

Vërejtja e dhënë se modeli me të cilin kemi ofertuar nuk përmbush parametrin e tensionit nominal i kërkuar sipas ANEKS 1 45/80 V nuk është i vërtetë. Modeli TSA 500 plotëson këtë kriter teknik, Tensioni nominal i saj është 72 V / maksimumi i tensionit 80 V, pra është brenda intervalit të përcaktuar në FDT - LOT 2, SPEC. TKENIK i KORIGJUAR 25.06.2025 (shqip, anglisht dhe serbisht).docx. Për më tepër AK ka cituar se modeli me të cilin kemi ofertuar ne si grup është me tension nominal 35 V, gjë e cila nuk qëndron ndërsa pozicioni / pika të cilës i referohet AK në këtë arsyetim sërish është i pasaktë pasi së pari 35 V si e dhënë nuk figuron në dokumentet e ofertës sonë dhe së dyti të dhënat në pjesën ku AK referon janë të paraqitura për bateri/njësi pra 36V + 36 V = 72 V (kjo shihet qartë tek te dhenat për tensionin dhe tek modeli foto – shih katalogun e prodhuesit të dërguar me ofertën tonë).

## Cordless power cutter TSA 500 B - AP system

**Battery-powered circular saw for cutting metal TSA 500 B**

The high-performance STIHL TSA 500 B cordless cut-off saw from the STIHL AP system is powered by two STIHL AP 500 S batteries. It is versatile and ideally suited for professionals in landscaping, construction, and emergency services, including fire departments. It reliably cuts and slices a wide variety of materials such as steel, concrete, brick, and natural stone. The ergonomic handles and rigid construction of the TSA 500 B allow for precise guidance during positioning and cutting. Device length 75 cm. The splash test is based, among other things, on the IPX4 standard. The STIHL TSA 500 B cordless cut-off saw has had its splash protection, already proven in internal tests, additionally certified to IPX4 protection class. The standard water connection allows for efficient dust suppression both indoors and outdoors, enabling efficient work with minimal strain. The **adjustable magnesium guard** with integrated water channel protects during operation. It channels dirt away effectively while simultaneously providing excellent visibility of the cutting disc.

| | |
|---|---|
| Nominal voltage | 72 V |
| Maximum voltage | 80 V |
| Power consumption | 5 kW |

| | |
|---|---|
| sound pressure level | 106 dB(A) [4] |
| Sound power level | 117 dB(A) [5] |
| Vibration value left | 2.4 m/s² |





| | |
|---|---|
| Battery system | AP |
| Recommended battery | AP 500 S |
| [illegible] | [2] |

Për më tepër katalogu ynë tregon sistemin e baterisë dhe baterin AP 500 S e cila është 36V dhe dy të tilla të konfiguruara në modelin TSA 500 japin tensionin 72 V, te gjitha keto kane qene pjese e katalogut por si duket vleresimi ka qene siperfaqesor ne oferten tone.

Autoriteti konkraktues ka shkelur ligjin e prokurimit publik gjatë procesit të vlerësimit, krahasimit dhe ekzaminimit të ofertës sonë duke mos kërkuar sqarim shtesë ashtu sic e lejon dhe përcakton ligji në rast paqartësie. Përveq argumenteve si më lartë katalogu i prodhuesit përmban modelin me të cilin kemi ofertuar, shihet qarte modeli i baterise per me teper modelet me te cilat kemi ofertuar ne në ketë aktivitet prokurimi jane pajisje lehte te verifikueshme dhe me pak kërkime në internet apo direkt në faqen e prodhuesit do te konstatohej permbushmeria apo jopermbushmeria teknike e pajisjes. Më poshtë mund të shihni burime të shumta zyrtare që tregojn tensionin e këtij modeli:

STIHL USA
https://www.stihlusa.com › en

TSA 500 Battery Powered Cut-off Machine - STIHL



Meet the STIHL TSA 500—your new go-to for high-performance cutting without the ...

**Max. voltage:** 80 V **Power:** 4.20 kW 1

**Power consumption:** 5 kW **Rated voltage:** 72 V

STIHL GB
https://www.stihl.co.uk › en

TSA 500 Cordless Cut-off Machine | STIHL




The TSA 500 is a 14" (350 mm) battery-powered cut-off machine in the STIHL AP System. Designed for professionals working in construction, hardscaping and pipework, it's an ideal choice for processing ...

**Battery system:** AP **Max. voltage:** 80 V

**Power:** 4.20 kW 1 **Rated voltage:** 72 V

stihl.ca
https://www.stihl.ca › en

TSA 500 - AP System



The STIHL TSA 500 is a powerful battery-powered cut-off machine designed for ...

**Max. voltage:** 80 V **Power:** 4.20 kW

**Power consumption:** 5 kW **Rated voltage:** 72 V

**Gjithsesi, autoriteti kontraktues ka shkelur ligjin pasi nuk ka kërkuar sqarime per paqartesit qe mund te kete patur, kerkesa e dosjes se tenderit ka qene nder te tjera katalogu i prodhuesit dhe ne si operator nuk mund te percaktojme formen apo permbajtjen e te dhenave qe perfshin katalogu, prandaj me vendoshmeri konstatojme shkeljen e autoritetit per mos kerkim sqarimi ne kete pike ndonese arsyetmi i dhene eshte arsyetim i kot perderisa katalogu permban vleren e tensionit total 72 V e fituar nga dy bateri 36Vx2 gje te cilen e deshmon modeli i baterise dhe vet modeli – pamja foto.**

2. Për pozicionin Nr.2. Motorsharre per prerje llamarine, AK ka dhënë arsyetimet për dy parametra teknik të pajisjes:
   - Për RPM 13000-13350 kërkuar sipas ANEKS 1, ndërsa AK arsyeton që oferta jonë nuk është e përgjegjshme për faktin që kemi ofertuar mbi nivelin e kërkuar përkatësisht 13500rpm. Për këtë pikë katalogu i prodhuesit përmban si vijon:

Petrol rescue saw MS 462 C-M R

**Petrol chainsaw for cutting sheet metal MS 462 C-M-R**

Professional rescue saw for firefighters the STIHL MS 462 CM R petrol offers special features that allow them to perform tasks in rescue operations faster and more effectively. Firefighters and members of the Federal Agency for Technical Relief (THW) can use this rescue saw to work precisely and cut through even resistant materials such as sheet metal, bitumen roofing felt, or wired glass. For this purpose, the rescue chainsaw is equipped with the extremely robust STIHL Rapid Duro R carbide-tipped saw chain with armor plating made of impact-resistant carbide plates.
The STIHL MS 462 CM R also boasts the following special features as a rescue saw: a large additional handle that makes starting the engine easier, even with gloves on.
Another handle for quick and easy adjustment of the cutting depth a cutting depth limiter for performing controlled plunge cuts.
$CO_2$ 704 g/kWh
Power-to-weight ratio 1.50 kg/kW
Maximum engine speed: 13,500 rpm ± 200

Katalogu i prodhuesit tregon të dhënat për RPM në ±200 e cilat duhet marr në konsideratë në nivelin rënës të RPM. Katalogu i prodhuesit tregon që Maximum engine speed është 13,500 rpm, mesatarja e dhënë në rrotullime e garantuar nga prodhuesi është 13,250rpm dhe kjo është në intervalin e përcaktuar nga AK. Gjithsesi RPM është një parametër shumë i rëndësishëm për një pajisje motorike andaj në asnjë mënyrë përmbushja apo tejkalimi i një parametri kaq të rëndësishëm nuk mund të konsiderohet mospërmbushje. Edhe në këtë pikë AK ka shkelur ligjin e prokurimit publik, do të duhej të kërkonte sqarim dhe ne do ti përgjigjeshim kërkesës duke dhënë sqarimet konkrete për secilën nga pyetjet apo paqartësit që do të mund të kishte AK.

   - E njëjta vlen edhe për parametrin që tregon zhvendosjen e cila është kërkuar brenda intervalit 70-71.9$cm^3$ ndërsa kemi ofertuar 72.2$cm^3$, numerikisht nisur nga 72.2$cm^3$ dhe niveli / intervali maximal i lejuar 71.9$cm^3$ gjejme si vijon:

Diferenca midis **71.9 $cm^3$** dhe **72.2 $cm^3$** është:

72.2−71.9=0.3 $cm^3$ 72.2 - 71.9 = 0.3 \{ cm}^3 72.2−71.9=0.3 $cm^3$

Pra, ndryshimi është **0.3 cm³**.

Si përqindje ndaj 71.9 cm³: 0.371.9×100≈0.42%, Një konfigurim i tillë i pajisjes nuk mund të përbëjë në asnjë mënyrë diskualifikim apo mospërmbushje. Gjithmon pretendimet tona qëndrojnë dhe i referohen parametrave dhe të dhanave të sakta që kemi ofertuar krahasuar me ofertën e operatorit të rekomanduar i cili nuk ka ofruar asnjë model për pajisjet e ofertuara, ka ofruar të dhëna për të cilat nuk është ofruar asnjë dokument dëshmi që me të vërtetë përmbushin kërkesat e kërkuara nga ANEKS 1, dhe të gjithë këto do t'i argumentojmë një nga një në secilin pretendim të kësaj kërkese.

Kete pretendim ankimor dhe te tjerat me radhe autoriteti kontraktues i hedh poshte duke i refezuar pa baze ligjore, me diskriminim te plote dhe anshmeri te plote duke favorizuar operator me oferte mashtruese/tendencioze. Ne pergjigjjen refuzuese te ketij pretendimi autoriteti kontraktues serish per Poz.Nr.1. i reereohet katalogut dhe te dhenave te baterise njesi ndersa mbyll syte per permbajtjen ne teresi te katalogut dhe ne pjese te tij ku eshte e pasqyruar qarte vlera e tensionit nominal 72V dhe max 80V

Cordless power cutter TSA 500 B - AP system

**Battery-powered circular saw for cutting metal TSA 500 B**

The high-performance STIHL TSA 500 B cordless cut-off saw from the STIHL AP system is powered by two STIHL AP 500 S batteries. It is versatile and ideally suited for professionals in landscaping, construction, and emergency services, including fire departments. It reliably cuts and slices a wide variety of materials such as steel, concrete, brick, and natural stone. The ergonomic handles and rigid construction of the TSA 500 B allow for precise guidance during positioning and cutting. Device length 75 cm. The splash test is based, among other things, on the IPX4 standard. The STIHL TSA 500 B cordless cut-off saw has had its splash protection, already proven in internal tests, additionally certified to IPX4 protection class. The standard water connection allows for efficient dust suppression both indoors and outdoors, enabling efficient work with minimal strain. The **adjustable magnesium guard** with integrated water channel protects during operation. It channels dirt away effectively while simultaneously providing excellent visibility of the cutting disc.

| | | | |
|---|---|---|---|
| Nominal voltage | 72 V | sound pressure level | 106 dB(A) [4] |
| Maximum voltage | 80 V | Sound power level | 117 dB(A) [5] |
| Power consumption | 5 kW | Vibration value left | 2.4 m/s² |

Per te shtuar diskriminimin dhe me shume AK i referohet ne menyre te pakuptimit udhezuesit 002/2024 00 dhe 001/2023 qe oferta duhet refuzuar menjehere pa kerkuar sqarime te metejme pasi sipas tyre katalogu i tyre eshte derguar por specifikacioni mungon.... Absolutisht i pabaze, perveq katalogut te prodhuesit i cili permban informata shume me shume se ato qe jane kerkuar pasi eshte katalog prodhuesi e JO KATALOG i pershtatur sic ka vepruar operatori i rekomanduar per kontrate. Kemi derguar SPECIFIKACIONIN TEKNIK ashtu sic e kerkon ligji duke e bashkengjitur ate ne deklaraten e specifikimeve teknike andaj nuk pajtohemi me vendimin e dhene as ne njoftimin e dates 4 qershor ' 26 dhe nuk pajtohemi as me vendimin refuezues ne kerkesen per rishqyrtim te dhene me date 11 qershor '26.

**Rekapitulim Pretendimi Nr.1.**

Eshte derguar katalogu me te gjitha te dhenat e kerkuara dhe me teper, katalogu permban modelin dhe prodhuesin,

- Eshte derguar deklarata e specfikave teknike se ciles i eshte bashkengjitur specifikimi teknik ashtu sic eshte kerkuar me FDT dhe Paramese – Specifikimet Teknike te Detyrueshme.
- Operatori i rekomanduar ka derguar vetem deklaraten e specifikave pa i bashkengjitur specifikimin teknik dhe nuk u refuzua...???
- Furnitori me te cilin kemi zgjedhur te ofertojme, nuk eshte kompani kineze e cila ndryshon katalogun apo permbajtjen e te dhenave te perfshira ne katalog ashtu sic mund ti pershtatet dikujt, por eshte kompani serioze qe ofron te dhena deri ne detaje per secilin parameter e funksionalitet te pajisjes.
- Prodhuesi i pajsijeve me te cilat kemi ofertuar ne si grup per te cilat per te dyten here radhasi vazhdon arsyetimi i pabaze dhe me shkelje ligjore qe nuk permbushin kerkesat e FDT, nuk ndryshon website brenda dy ditesh vetem per tu dukur qe prodhon pajisje te cilat as qe i ka prodhuar ndonjehere.
- Poz. Nr.1 permban vlera teknike te tensionit ne total dhe te baterive ne njesi – eshte kontatim i gabuar arsyetimi se "ne katalogun e juaj figuron 36V" kur pjesa ku referohet arsyetimi eshte bateria njesi AP 500S ndersa 72V eshte ne pjesen e pare – fillimit te katalogut,
- Pergjegjesia shoqerore dhe siguria e njeriut eshte mbi cdo interes, nuk matet financiarisht dhe nga ky fakt eshte punuar

oferta jone, JO me pajisje te cilat as certifikim qe jane per tregun europian nuk kane.

**Pretendimi Ankimor Nr. 2. Specifikacioni Teknik i Detyrueshëm**

**Deklarata e Specifikave nuk është dërguar e kompletuar me Aneksi 1 SPECIFIKIMET TEKNIKE TE DETYRUESHME -** LOT 2, SPEC. TKENIK i KORIGJUAR 25.06.2025 (shqip, anglisht dhe serbisht).docx.**, ashtu sic e kërkon LPP.**

OE, i rekomanduar për kontratë ka dërguar vetëm deklaratën mbi specifikimet teknike por nuk ka bashkëngjitur ANEKS 1. Pra MUNGON SPECIFIKACIONI TEKNK PER MALLRAT E OFRUARA Ligji i prokurimit publik dhe udhezuesi i prokurimit publik kerkojne specifikimin teknik nga ANEKS 1 te dergohet se bashku me deklarate edhe atehere kur eshte kerkuar katalogu per furnizimet sipas kërkesës së FDT-së. Në rast të mos dërgimit të këtij dokumenti apo deklarate të plotë oferta e operatorit do të duhet të refuzohet menjëherë pas kërkuar sqarim të mëtutjeshëm. Prandaj, konstatojmë që OE është rekomanduar për kontratë padrejtësisht nga AK, oferta e tenderuesit është e papërgjegjshme.
ANEKS 1 Specifikimet Teknike te Detyrueshme ne kuader te FDT-se autoriteti ka publikuar specifikimet teknike te cilat do te duhej te ishin te bashkengjitura ne deklaraten e specifikave ashtu sic e perckaton ligji i prokurimit publik dhe pikersht ky do te duhej te ishte njeri nder arsyetimet e tjera te shumta te cilat AK do te duhej ti kishte te perfshira ne vendimin per eliminimin e ofertes se RUNWAY e jo te bente te kunderten kur faktet kete here nuk jane asnjera prej tyre ne favor te autoritetit apo operatorit te rekomanduar.

| | | |
|---|---|---|
| Mungon specifikacioni teknik për mallrat e ofruara dhe katalogu (“specifikimit teknik” – AK përcakton kërkesat minimale dhe maksimale të një produkti, ndërsa OE duhet të dorëzoj specifikimin e detajuar të mallrave të ofruara. Përveç ne raste kur OE nuk mund të dorëzoj specifikimin teknik të një produkti të caktuar p.sh. peme/ përime etj. OE dorëzon deklaratën ku deklaron se mallrat do të jene ne përputhje | Refuzo tenderin pa kërkuar informacion të mëtejshëm | 28 |

41

UDHËZUES Nr.001/2023 PËR PROKURIMIN PUBLIK

| | | |
|---|---|---|
| me specifikimin e kërkuar) | | |

| | | |
|---|---|---|
| Është dorëzuar katalogu por mungon specifikacioni teknik për mallrat e ofruara | Refuzo tenderin pa kërkuar informacion të mëtejshëm | 69 |

Moskompletimi i dokumenteve të ofertës nga ana e operatorit të rekomanduar tregon se i njëjti ka vepruar me planifikim për të humbur cdo mundësi verifikimi të dhënash për pajisjet me të cilat ka ofertuar. Nëse AK (komisioni vlerësues) ka bërë ekzaminimin me kujdes ka vërejtur qartë se asnjëri nga pasjijet e ofertuara nuk përmban llojin / modelin e pajisjes, kjo nuk ndodh asnjëherë në një katalog prodhuesi. Një gjë e tillë nuk është rastësi pra është e menduar mirë që të manipuloj AK me të dhënat e ofruara kinse oferta e tij është e përgjegjshme.  Andaj OE i rekomanduar ka zgjedhur që deklaratës së specifikave teknik të mos i bashkëngjes LOT 2, SPEC. TKENIK i KORIGJUAR 25.06.2025 (shqip, anglisht dhe serbisht).docx.

**Autoriteti ne vendimin refuzues te dates 11 qershor ’26 pergjigjet:**

2. **Përgjigjja e AK-së ndaj pretendimit ankimore nr.2:Autoriteti kontraktues kriter ne FDT ka pasur si vijon: Katalog nga prodhuesi me të cilën është e mundur vlerësimi i specifikave teknike të ofruara qe specifikon saktë pajisjet e kërkuara sipas LOT-ve.**

Operatori ekonomik i rekomanduar për dhënien e kontratë, ka dorëzuar me ofertë katalogun e prodhuesi **ODETOOLS përkatësisht prodhuesit kinez ODE TECHNOLOGY** me përmbajtjen e specifikimit teknik i cili është vlerësuar, krahasuar dhe ekzaminuar mbështetur ne specifikimin teknik te kërkuar për LOT 2 dhe vlerësuar mbështetur ne Nenin 59 te LPP dhe Nenin 40 te RrPP Nr. 001/2024.

Vleresimi ne Nenin 59 LPP, Nenin 40 RrPP, 001/2024 eshte pershkruar por zbatuar asnjehere.
Faktet:

- Poz.15. Thike shpetimi emergjente – nuk permban bazen e standardeve te prodhimit *“Te jete i prodhuar sipas direktivave 2002/96/EC, 2004/108/EC“,* nuk eshte ofruar asnje dokument deshmi e as nuk jane pershkruar ne katalog, kerkesa per gjatesi, gjeresi dhe lartesi nuk eshte konform kerkeses se FDT, Deshmi katalogu i ODETOOLS,
- SoftGrip™ dhe FiberComp™ , sipas rregullave per marka tregtare dhe patentime ™ dhe $^{R}$ jane te aplikueshme vetem per mbajtesit e tyre ndersa ne mesin e kompanive prodhuese ne bote ODE Technology respektivisht brendit ODETOOLS nuk figuron askund,
- Poz.1. SHARRE RRETHORE PER PRERJE TE METALIT ME BATERI, ne katalogun e ODETOOLS te derguar me oferten e operatorit te rekomanduar nuk permban te dhenat sic jane: gjatesia e pajisjes - po diskutojme per SPECIFIKA TEKNIK TE DETYRUESHME, pastaj pajisja ne katalogun e ofertuar posedon bateri e cila punon vetem ne temperatura te ftohta nga -10 dhe ne -40ºC ndersa nuk funksionon ne temperatura te larta sic kerkohet me FDT dhe ate deri ne +40 ºC

**Katalogu OE RUNWAY**

ODETOOLS

CIRCULAR METAL CUTTING SAW WITH BATTERY

Professional circular saw for firefighters, designed for heavy-duty work and emergency interventions, with an ergonomic handle and IP45 protection rating.

Saw blade: 12" (300 mm / 3.5 mm / 20 mm).

Suitable for operation in temperatures from -10°C to -40°C.

**Kerkesa SPECIFIKIMET TEKNIK TE DETYRUESHME**

| Nr. | PERSHKRIMI I PRODUKTIT | N |
|---|---|---|
| 1 | **SHARRE RRETHORE PER PRERJE TE METALIT ME BATERI**<br><br>Sharre rrethore profesionale per zjarrfikes per pune te renda dhe nderhyrje emergjente me doreze mbajtese ergonomike dhe shkalle te mbrojtjes IPX4, Disku 12" (300mm/3.5mm/20mm), Per pune ne temperatura Bateria -10°C deri ne min 40°C , | k |

Mungon te dhenat qe pajisja permbush kerkesat per kontrol panel, sistem furnizimi me uje.

- Poz.2. MOTORSHARRE PER PRERJE LLAMARINE, nuk eshte pajisje e kategoris “RESCUE” edhe pse emertimi i shkruan, i mungon doreza per rregullim te prerjeve, e kemi argumentuar edhe me foto si me poshte, ndersa pamja qe tregon katalogu i ofertes se RUNWAY, nuk eshte model / pajisje se ciles mund te montohet nje pjese doreze si kjo qe eshte kerkuar, foto ne katalogun e tyre tregon nje motosharre druri e jo nje motorsharre qe perdoret per raste emergjente e prerje llamarine, kjo nuk mund te ju kete ikur komisionit vleresues.



- Poz.4. SHARRE RRETHORE PER PRERJE TE BETONIT, ne katalogun e RUNWAY nuk permban te dhenat teknike si: fuqia, zhvendosja, rpm, ISO 7293, Prandaj pergjigja e autoritetit se OE i rekomanduar ka derguar katalog me permbajtjen e specifikimit teknik bazuar ne te cilin eshte bere vleresimi dhe eshte dhene vendimi per rekomandim me pas, Nuk eshte konstatuar asnje nga keto mospermbushje – cila metode u perdor ne kete vleresim dhe cila u perdor per oferten tone???, Eshte absurde ne nje mori shkeljesh te argumentuara te mbeshtetesh serish ne nje vendim t'a themi te dyte ne refuzimin e kerkeses sone duke mbajtur anesi per oferte e cila perveq qe manipulese i mungojne shume te dhena qe jane kerkuar dhe serish favorizimi vazhdon.

**Pretendimi Ankimor Nr. 3. Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale / Lista e kontratave**

Kërkesat për mundësitë teknike dhe/ose profesionale ka qenë për kontrata apo furnizime të kryera të natyrës së njëjtë apo të ngjajshme ndërsa OE i rekomanduar asnjë nga referencat e dërguara nuk e posedon për furnizime që kanë të bëjnë me pajisje të natyrës sic janë kërkuar në LOT 2. Vendimi i AK për të rekomanduar për kontratë një operator që asnjëherë të vetme nuk ka furnizuar pajisje sic janë kërkuar në këtë LOT të bënë të kuptosh se kemi të bëjmë me një vlerësim jo transparent, shume diskriminues përcjellur me shkelje të shumta. Kërkesa që operatori ekonomik të ofroj dëshmi për furnizime të realizuara me artikuj që jane pjese e udhëzimit administrativ 08/2019 është kërkesë e përgjithshme pasi i tërë aktiviteti është i përbërë nga disa LOT-e pjesë ku secili prej tyre përmban artikuj të ndryshëm prej tjetrit andaj si kërkesa ashtu edhe dëshmia dokumentare bazohet në natyrën e secilit. Është e pakuptimit të rekomandohet për kontratë një operator që të gjitha furnizimet e kryera i ka veshmbathje dhe dyshek.

Përveq mospërmushjes së kërkesave minimale për mundësit teknike dhe/ose profesionale operatori i rekomanduar ka dërguar listë të referencave dhë vend të listës së kontratave ashtu sic e përakton ligji i prokurimit publik dhe cdo ndryshim nga formularët standard nga ana e operatorit ekonomik përbënë shkelje ligji së pari dhe së dyti e bënë të paërgjegjshëm ofertën e operatorit e cila sipas ligjit në një rast si ky do të duhej të eliminohej / refuzoje menjëherë. Konform Neni 44
Formularët Standard , operatorit i lejohet të vendos logon e kompanisë apo header por nuk i lejohet të ndryshoë përmbajtjen duke mos përfshirë as kërkesa minimale që përcakton formulari. Operatori i rekomanduar për më tepër ka ofruar listë të referencave pra nuk ka dërguar fare listë të kontratave pasi dihet mirë elementet që duhet të përmbaj lista e kontratave. Lista e kontratave të realizuara sipas rregullores nr. 001/2022 për prokurimin publik të plotësuar dhe ndryshuar me rregulloren 002/2024 për prokueim publik, Neni 44.3 citon që qëllimi i dokumenteve standarde është që të ndihmohen operatorët ekonomik gjatë përgaditjes se ofertave. Deklaratat duhet të përmbajnë kërkesat minimale të përcaktuara në formularët standard pa ndryshime në përmbajtje, pa prezentimin e kufizimeve apo kushteve shtesë, ose pa fshirjen e ndonjë kushti të përcaktuar nga autoriteti kontraktues në format standarde. Por kompania që bënë deklaratën ka të drejtë që të vendos logon, emrin e kompanisë apo grafikë në krye të faqes "header" apo kujtdo tjetër në dokumentet standarde. Pra, sipas nenit të lartë përmendur OE përveq vendosjes së logos dhe / ose merit të kompanisë si dhe plotësimit të fushave aty ku kërkohet nga AK, NUK IU LEJOHET të bëjnë cfarëdo ndërhyrje duke shtuar apo modifikuar format standarde.

Si më poshtë është dokumenti i dërguar nga operatori i rekomanduar:

Lista e referencave

| Lista e referencave 2022-2024 | | | |
|---|---|---|---|
| Titulli i kontratave | Autoriteti Kontraktues | VLERA euro | VITI |
| Furnizim me uniforma te zjarrfikës për nevojat e FSK-së 217 23 4183 121 | Ministria e Mbrojtjes | 77,550.00 € | 2023 |
| Furnizim me veshmbathje- uniforma 214 23 1262 121 | Akademia e Kosovës për Siguri Publike | 47,978.80 € | 2023 |
| Furnizim me veshmbathje | A & V Collection NP | 103.015.00 € | 2023-2024 |
| Furnizim me Dyshek | Akademia e Kosovës për Siguri Publike | 14,475.00 € | 2024 |
| Totali | | **243.018.8 €** | |

Ndërsa kërkesa e autoritetit ka qenë për listë të kontratave që ndër të tjera përmban datën e pranuesit, pranuesin dhe të dhënat të tjera që përcakton formulari:

| NR. | Titulli i kontratës | Data e nënshkrimit te kontratës | Data e përfundimit te kontratës | Vlera totale e kontratës | Emri i Blerësit | E-maili i Blerësit | Numri i telefonit te Blerësit |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 1 | | | | | | | |
| 2 | | | | | | | |
| 3 | | | | | | | |
| 4 | | | | | | | |
| 5 | | | | | | | |
| 6 | | | | | | | |
| 7 | | | | | | | |

(Shto/fshij sipas nevojës)

Autoriteti Kontraktues ka të drejtë të verifikojë të dhënat e paraqitura në këtë Aneks dhe nëse vërtetohet ndonjë dëshmi e rreme, oferta e tillë do të konsiderohet si një oferte e pa përgjegjshme dhe për shkak të paraqitjes së të dhënave të rreme, do të kërkohet nga Organi Shqyrtues i Prokurimit për të vënë atë në listën e zezë te Operatoreve Ekonomik.

Ne kete pretendim autoriteti refuzon pretendimin duke cituar se AK nuk ka percaktuar formen e listes se kontratave, nje pergjigjje e dhene e pabasueshme te ipet nga nje autoritet si ky, lista e kontratave eshte e percaktuar me rregullore ashtu sic e kemi cituar ne pretendim dhe si e tille duhet te jete pjese e FDT-se cdo here dhe cdo nderhyrje ne te perbene shkelje. Pastaj OE i rekomanduar ka derguar liste te referenave – uniforme dhe dyshek por nuk ka derguar dokument i cili mund te kishte cfaredo forme apo permbajtje por te pakten emrin do t'a kishte Lista e Kontratave. Cdo ndryshim nga formularët standard nga ana e operatorit ekonomik përbënë shkelje ligji së pari dhe së dyti e bënë të papërgjegjshëm ofertën e operatorit e cila sipas ligjit në një rast si ky do të duhej të eliminohej / refuzoje menjëherë. Konform Neni 44

**Pretendimi Ankimor Nr. 4. Certifikata ISO 9001 (e prodhuesit),**

Operatori ekonomik i rekomanduar për kontratë ka dërguar katalogun në të cilin është mbishkruar brendi ODETOOLS i prodhuesit kinez ODE TECHNOLOGY dhe nisur nga kjo kuptojmë që për LOT 2 kjo kërkesë e AK si duket është menduar nga operatori i rekomanduar që të përmbushet me certifikatën ISO 9001 të ODE TECHNOLOGY. Në fakt në këtë pikë konstatojmë sërish shkelje të ligjit të prokurimit publik gjatë vlerësimit të ofertave pasi fusha e menaxhimit të kualitetit konform së cilës është e vlefshmë ISO e prodhuesit të lartë përmendur nuk përmbush fushëveprimtarin prodhuese të të gjithë artikujve me të cilët ka ofertuar operatori RUNWAY SHPK.

**Quality Management System Certification Certificate**

**ODE TECHNOLOGY CO.,Ltd**

**Certificate No.:1952024Q1066R1M**

**Unified Social Credit Code:**91330108566057073I

**Registration Address:**Room 1304, Mengbao Building, No. 219 Binkang Road, Xixing Street, Binjiang District, Hangzhou City,Zhejiang Province, China

**Business Address:** Building 3, Ode Group, No. 119, Qihang Road, Leidian Town, Deqing County, Huzhou City, Zhejiang Province

**Management system conforms to the standard:GB/T 19001-2016/ISO 9001:2015**

**The certificate is valid for the scope:**Production And Sales Of Professional Equipment Manufacturing (Hydraulic Motors, Hydraulic Pumps, Hydraulic Components, Electric Hydraulic Tools, and Rescue Tools) (Except For Administrative Licensing Requirements)

Pra, nga sic shihet si më lartë certifikata ISO 9001 e dërguar vlen vetëm prodhimin dhe shitjes e pajisjeve profesionale si motor hidraulik, pompa hidraulike, komponente hidraulike, vegla elektrike hidraulike dhe vegla emergjente por kjo certifikate nuk mbulon pajisjet si ajërfryese, brisk / thikë shpëtimi, vegla të tjera si lopata, kazëm, sopata të cilat janë pjesë e këtij aktiviteti pasi kjo kompani nuk i prodhon fare këto kategori të pajisjeve. Madje madje kjo kompani pajisjet si motorsharra qoftshin ato druri, betoni apo metali nuk i ka fare të kategorisë profesionale për përdorim emergjent pasi asnjërën prej tyre nuk e ka të vërtetuar mbi bazën e standardeve prodhuese të aplikuara në prodhim dhe këtë e dëshmon fakti mbi të cilën është certifikuar për menaxhim të cilësisë/kualitetit ashtu sic e argumenton fakti nga CE – deklarata e konfirmitetit e cila është e përcaktuar vetëm në pajisjet hidraulike të përcaktuara sipas modelit .

**Holder of Attestation: ODE Technology Co., Ltd.**
1701 Room,Mengbao Building
No. 219 Binkang Road
Xixing Street
Binjiang District
310052 Hangzhou City, Zhejiang Province
PEOPLE'S REPUBLIC OF CHINA

**Product:** **Hydraulic Breaker**
**Battery Rescue Tool**

**Model(s):** **SC370-E, SP725-E, S251-E, S171-E, R412-E, R530-E**

**Parameters:** Rated voltage: 28.8Vd.c.
Degree of protection: IP54

Konstatojmë që kërkesa për certifiaktën ISO 9001 nukpërmbush kërkesën e AK përderisa ODE TECHNOLOGY nuk ka të përfshirë në fushën e certifikimit kategori të produkteve pjesë e aktivitetit apo LOT 2. Përderisa një kompani në certifikimet e saj nuk përfshin një apo disa kategori artikujsh do të thotë që nuk ka arritur të plotësoj kërkesat e standardit për certfikim dhe këtë mosplotësim kërkesash e hasim në të dy dokumentet zyrtare të ODE TECHNOLOGY.

Autoriteti kontraktues, refuzon kete pretendim dhe pretendimet tjera te listuara si me poshte me arsyetime qe perveq qe nuk kane baze ligjore nuk kane as baze logjike.

Ne, nuk e kemi kontestuar certifikaten ISO 9001 te prodhuesit ODE Technology, nuk jemi ankuar qe nuk e posedon POR jemi ankuar qe ODE Technology eshte i certifikuar me ISO 9001 per pajisje ne fushen e se cilave nuk jane te perfshira pajisje apo artikujt si: thike shpetimi, lopate paloseshe, kazem, cekan dhe te tjera, ashtu sic jemi ankuar qe per pajisjet pjese e LOT 2 ky prodhues nuk posedon deklarate konfirmiteti. Si autoritet kontraktues qe eshte nuk mund te mos e kuptoje cfare do te thote CE – deklarata e konfirmitetit, si leshohet ajo, permbajtja e saj etj. Pra, e kemi argumentuar permbajtjen e certikates ISO 9001 e cila i referohet pajisjeve hidraulike dhe atyre te kategoris "RESCUE" por ne LOT 2 nuk eshte kerkuar asnje pajisje hidraulike ndersa ato qe jane kerkuar nga kategoria RESCUE e kemi argumentuar qe nuk jane pjese e katalogut zyrtar te prodhuesit, linkun e katalogut e gjeni si me poshte:
ODE RESCUE TOOLS CATALOG-2026.pdf
I cili eshte konfirmuar nga kompania ODE Technology qe eshte katalog i kategorise RESCUE i vitit 2026 dhe qe i permban vetem pajisjet te cilat jane pjese e katalogut e ne kete katalog shihet qe nuk figurojne artikujt per te cilet OE i rekomanduar pretendon qe prodhohen nga kjo kompani dhe nen brendin ODETOOLS.




Ndersa pajisjet e ofertuara ne diten kur eshte dhene vendimi per kontrate i dates 4 qershor '2026 deri ne daten 9 qershor kur ne kemi derguar kerkesen per rishqyrtim nuk kane figuruar as ne website zyrtar te prodhuesit. Me pak kronologji dhe ndjekje te menys brenda faqes se tyre verehet qarte ndryshimi i shpejt ne permbajtjen e faqes qe eshte bere, jane vendosur te parat pikerisht pajisjet qe lidhen me LOT 2, por qe vigjilenca per te kamufluar tere kete me perpjekjen qe te duken te pergjegjshem ne shume pika i ka tradhtuar dhe per kete i kemi te gjitha argumentet.

**Pretendimi Ankimor Nr. 5. Katalogu**

Me të patur qasje në dokumentet e operatorit të rekomanduar kemi vërejtur që në katalog në kuadër të brendit ODETOOLS

përkatësisht prodhuesit kinez ODE TECHNOLOGY janë përfshirë pajisje të cilat nuk i prodhon kjo kompani.
Nuk pajtohemi me vendimin e dhënë nga AK pasi kemi konstatuar një seri shkeljesh të një pas njëshme në secilën prej kërkesave të këtij aktiviteti. Nuk pajtohemi me përmbajtjen e katalogut pasi shihet qartë tendenca për manipulim/mashtrim përderisa në secilën prej pajisjeve aty ku ka patur mbishkrim është fshirë ai ashtu sic nuk është fshehur modeli më të cilën pretendohet se është ofertuar. Konsiderojmë të ketë të dhëna të pavërteta apo të shtrembëruara për faktin se janë fshehur të dhëna bazike të cilat tregojnë saktë modelin e ofertuar ashtu sic janë përshkruar të dhëna kinse të vlefshme për pajisjen por që në fakt janë tëresisht përshkrim nga paramasa në mos të themi një përkthim shumë i dobët në gjuhën angleze i cili nuk i ngjan aspak katalogut të një fabrike prodhuese.
Ashtu sic eshte shkelur Neni 7. Barazia në Trajtim/ Jo-Diskriminimi janë shkelur me radhë
Neni 6. Ekonomiciteti dhe Efikasiteti
Neni 66 Përshtatshmëria Profesionale
Neni 69 Aftësia Teknike dhe/ose Profesionale
Neni 28. Specifikimet teknike
Neni 70. Standardet për Sigurimin e Cilësisë
Neni 59 Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahasimi i Tenderëve
Argumentet tona nuk janë të bazuara vetëm në kërkimet në internet ndonëse website zyrtar i kompanisë flet shumë, pasi ne kemi kontaktuar direkt fabrikën ODE TECHNOLOGY nga e cila kemi pranuar katalogun me të rë produktet që ata prodhojnë, madje madje zyrtarë të kësaj kompanie kanë konfirmuar që tërë gama që ata prodhojnë është e përfshirë në katalog ndërkohë që në katalogun e tyre përveq që kemi konstatuar mospërmbushje të shumta teknike për modele të caktuara kemi konstatuar që kjo fabrikë nuk prodhon thikë shpëtimi, nuk prodhon kazma, cekan, lopata dhe / apo sopata.
Si më poshte faktet qe tregojn se ODE TECHNOLOGY nuk prodhon produktet e cekura si me larte:













Nuk mund të pajtohemi me një proces diskriminues, jo të drejtë dhe nuk mund të pajtohemi të jetë i rekomanduar një operator me një ofertë manipuluese me të dhëna të përshkruara, janë të gjitha këto shkejle ligjit. Pastaj ligji i prokurimit publik përcakton rregullat, udhëzimet dhe mbi të gjitha ka qëllimin e qartë të cilat duhet të vlejnë për të gjithë dhe jo të konsiderohet e papërgjegjshme oferta jonë si grup operatorësh me arsyetime të cilat së pari tregojnë që oferta nuk është vlerësuar me kujdes dhe së dyti tregojnë tendencën favorizuese për një operator të papërgegjshëm i cili vetëm i përgegjshëm dhe me ofertë ekonomike nuk

mund të quhet, po të ishte ndryshe nuk do të zbatonte ligjin duke kërkuar sqarime shtesë për paqartësit që mund të kishte ndonëse oferta jonë përmban cdo element qartë dhe saktë nuk është se kishte hapësira konfuzimi por meqë AK vlerësoi arsyetime të tilla do të mund të kërkonte sqarime.

Daum të theksojmë se udhëzimi i MPB të brendshme përcakton pajisjet mbrojtëse dhe të tjera të cilat së pari kontribuojnë në siguron e personave që i ekspozohen direkt rrezikut për të shpëtuar të tjerët ndërsa me këtë vendim shohim që AK vetëm sigurin nuk mund t’a ketë prioritet, po të kishte do të vlerësonte dhe ekzaminonte më me kujdes për përmbajten e ofertave, për modelet, për saktësin e të dhënave të ofertuara. Siguria, Jeta e personave të ekspozuar direkt rrezikut nuk mund të matet me vlerë / cmim ekonomik. Një pajisje që mudn të kushtojë më shumë sot do të thotë jetë të shpëtuara më shumë nesër ndërsa një pajisje pa model së pari, pa të dhëna të konfirmuara qofshin ato teknike apo mbi bazën e standardeve që janë prodhuar për sot mund të konsiderohet më e volitshme por në të ardhmen do të mund të kushtojë me jetë madje me shumë sosh.

Argumentuar: Poz. 2. LOT 2 – Fotoja si më poshtë është e paraqitur në katalogun e ofertës së RUNWAY



Ndërsa foto e radhës është foto e marr nga katalogu i prodhuesit



Vijon Poz.5. Prezentuar në katalogun e ofertës



Nga katalogu i prodhuesit ODE TECHNOLOGY / ODETOOLS





Dhe kjo tregon saktë qëllimin tendencioz bazuar në të cilën nuk janë prezentuar modelet apo janë fshirë në tërësi aty ku pajisja (foto) përmbante model apo të dhëna të cilat do të mund të përdoreshin për verifikim. Një gjë e tillë e të vepruarit është tentim për të vënë lajthitje autoritetin, është mashtrim me të dhëna të shtrembëruara / përshtatura gjoja janë në harmoni me kërkesat e AK.

Se oferta e operatorit ekonomik të rekomanduar për kontratë është një ofertë me të dhëna të përshtatura / përkthim i dobët nga kërkesat që AK kishte vendosur dhe kjo është e dukshme.

Pjesë e marrë nga Poz. 2.

| | |
|---|---|
| Fuel type | Gasoline with emissions not exceeding 711 g/kWh |
| Fuel tank capacity | 0.77L |
| The chainsaw is equipped with a carbide chain suitable for cutting resistant materials and a 50 cm guide bar. | |

Emetimi i gazit është vlerë numerike prandaj kufizimi në “jo më shumë se” vlen prej 0 deri në 711është një interval shumë i gjerë vendosur nga AK, ndërsa për një prodhues që zbaton standardet që janë kërkuar në FDT nuk është kërkesë problematike . Pastaj “equipped” nuk është gabim që bëhet nga një prodhues dhe ky nuk është i vetmi.

Marr nga Poz .3.

Portable air blower (gasolime) professional for frefighters with anti-vibration

Marr nga Poz. 5.

Një prodhues asnjëherë në katalogun e tij dhë për pajisje të që vet prodhon një shpatë nuk e quan “BAR” dhe asnjëherë nuk citon “me minimum 10 teeth” nuk është terminologji prodhuesi kjo.  Pastaj pjesë në shqip në katalogun pseudo ODETOOLS nuk konsiderohet rastësi është përshtatshmëri, një interval 106-109 dB(A) nuk është parametër që jep një prodhues, mund të jap nivelin e garantuar dhe të matur varëisisht nga baza që kërkon standardi por siq është përshkruar nuk ndodh asnjëherë.

Input power 3 KW

Net weight : 4.5 kg Bar 45 cm with minimum 10 teeth

For operation in temperatures Battery -10°C up to min 40°C Niveli i

Garantuar i fuqisë së zhurmës: 106-109 dB(A) according to 2000/14/EC

Marr nga Poz .6.

Mufactured for the European market.

Marr nga Poz. 15

Një model i ofertuar PA MODEL që fillon (përkthyer në shqip) : thikë xhepi për zjarrfikës i cili përfshin në minimum..... e pastaj tregon parametra teknik sërish në minimum, the knife have...janë vetëm disa prej kopjes së dobët për tu dukur që oferta e tyre është e përgjegjshme dhe në harmoni me kërkesat e LOT 2.

EMERGENCY RESCUE KNIFE

Pocket knife for firefighters which include at minimum: large folding blade, screwdriver, window breaker (movable)
Strong Can/Bottle Opener with: Bottle Opener;Wire Remover
Punch, pusher, seatbelt cutter, key, pliers, toothpick, saw disk for shatterproof glass (movable), luminescent handle, nylon cord, nylon pouch (knife holder)
The knife have a locking blade for one-hand opening, thickness 2.45 mm
The knife have a drilling diameter 3.13 mm and hardness 55.5 HRC *, δ = 0.5 HRC
**Strong screwdriver min 6.9 mm, drilling diameter min 3.00 mm, hardness 54.0 HRC**
Resistant glass disk blade thickness 2.43 mm, slot min 4.59 mm, hardness 54 HRC
Manufactured for the European market.



▼ DIMENSIONS

| Width: | 35mm |
|---|---|
| Weight | 170g |
| Length | 117mm |
| Height | Ø10 mm |

Argumentet e cekura janë baza jonë e fortë se parregullësit dhe shkeljet e ligjit kanë ndodhur , se diskriminimi në ofertën tonë si grup operatorësh ka ndodhur dhe është evident.

**Pretendimi Ankimor Nr. 6. Standardet / Testimi**

Lot 2 në kërkesat e vendosura në disa pozicione ndër të tjera përfshijnë kërkesat për standardet e aplikuara gjatë procesit të prodhimit, janë pajisje për përdorim në emergjenca dhe duke qenë të tilla mbulueshmërin e tyre e tregon deklarata e konfirmitetit e cila për modelet pjesë e këtij LOT-i nuk është dërguar nga operatori i rekomanduar për kontratë. Deklarata e konfirmitetit që është dërguar dhe e cila ëshhtë në emër të ODE TECHNOLOGY sërish i referohet vetëm disa modeleve hidraulike dhe standardeve të aplikuara për to, por që nuk përfshin asnjërin prej modeleve për të cilat ka dërguar ofertë operatori në fjalë.
Përshkrimi i standardeve në të ashtuquajturin katalog sërish edhe në këtë pikë kriteresh është një copy paste nga Specifikimi Teknik i LOT 2, po të ishin përmbushëse do të vërtetoheshin apo do të ishin pjesë e deklaratës së konfirmitetit. Kërkesat për standarde dhe material për disa prej pozicioneve të aktivitetit LOT 2 janë kërkesa që në rast plotësimi dëshmohet dokumenti konkret ose nuk plotësohen fare si në këtë rast andaj vetëm janë përshkruar në ofertë.

Poz.2. është kërkuar që pajisja të jetë e certifikuar se është testuar konform standardeve, ndërsa këtë kriter nuk e plotëson oferta e OE-së së rekomanduar. Me qasjen e lejuar në dokumentacionin e ofertës kemi verifikuar që dokumenti i dërguar me emërtim nga OE si:

| | | | |
|---|---|---|---|
| PDF Test raporti Lot 2 dhe Lot 4 _CE | Microsoft Edge PDF Docu... | 2,669 KB | No |

është për modelet si:

| | |
|---|---|
| Test sample: | Battery Rescue Tool |
| Type of test object: | Battery powered, hand-held |
| Trademark: | N/A |
| Model and/ or type reference: | SC370-E, SP725-E, S251-E, S171-E, R412-E, R530-E |
| Rating(s): | 28,8Vd.c.; IP54; other ratings refer to table below |
| Manufacturer: | Same as applicant |

Dhe secili nga këto modele i referohet pajisjeve që nuk kanë të bëjnë më asnjërin prej pajisjeve të ofertuara. Këtë e kemi konstatuar dhe vërtetuar bazuar në modelet e cekura në këtë dokument.




| Battery Combi tool | SC370-E | SC507-E | SC357-E |
|---|---|---|---|
| Number | 12030165 | 12030065 | 12030056 |
| Rated Pressure | 72Mpa | 72Mpa | 72Mpa |
| Max Cutting Force/Opening Distance | 940KN/300mm | 780KN/300mm | 800KN/280mm |
| Cutting Capacity(Q235A Material) | ф38mm/ф20mm steel plate | ф32mm/ф12mm steel plate | ф32mm/ф8mm steel plate |
| Max Spreading Force/Expansion Distance | 40-1800KN/390mm | 40-1800KN/390mm | 50-1500KN/380mm |
| Max Tensile Force/Tensile Distance | 95KN/300mm | 80KN/300mm | 71KN/280mm |
| Weight | 18kg(without battery) | 19kg(without battery) | 18.5kg(without battery) |
| Dimensions | 960*230*270mm | 960*230*270mm | 975*220*270mm |





| Battery ram | R530-E |
|---|---|
| Number | 12040004 |
| Rated Pressure | 72Mpa |
| 1 Stage pushing Force | 140KN |
| 2 Stage pushing Force | 70KN |
| 1 Stage extended length | 400mm |
| 2 Stage extended length | 345mm |
| Closed Length | 540mm |
| Extended length | 1285mm |
| Weight | 19.7kg(without battery) |
| Dimensions | 540*150*360mm |

**Lightweight Battery Door Breaker**

| | |
|---|---|
| Number | 1216000 |
| Spreading Distance | 215mm |
| Cutting Opening Distance | 120mm |
| Capacity | 22mm |
| Minimum Spreading Force | 24KN |
| Spreading Distance of Door-Breaching | 195mm |

Pra, nuk është dhënë asnjë dokument dëshmie si certifikatë ekzaminimi që pajisja është testuar.

**Pretendimi Ankimor Nr. 7. Poz. 1. Mospërmbushjet**

- Është kërkuar që pajisja të ketë bateri e cila mund të funksionoj në temperatura të ftohta -10°C dhe në temperatura të larta në min 40°C ndërsa operatori i rekomanduar ka ofruar pajisje me bateri e cila mund të punoj në temperatura -10°C deri në -40°C, si e tillë bateria nuk mund të funksionoj për punë në raste kur temperaturat i ofrohen zeros (0) apo tejkalojnë zeron (0).

- Është kërkuar që pajisja të ketë diskun 300mm/3.5mm/20mm ndërsa bazuar në foton e paraqitur në dokumentet e ofertës dhe në katalogun zyrtare të prodhuesit të cilin e kemi siguruar ne, konstatojmë se pajisja nuk plotëson kërkesat e AK. Për më tepër një gjë e tillë shton më shumë peshën e ankesës sonë pasi argumentet janë qartë të dëshmueshme për ofertë manipuluese / papërgjegjshme.

**Katalogu zyrtar i prodhuesit :**



| | 40V Battery Cordless Saw | 80V Battery Cordless Saw | 80V Battery Cordless Saw |
|---|---|---|---|
| Model Number | QGJL0008 | 12100054 | 12100039 |
| Voltage | 4.0AH/40V | 5.0AH/80V | 6.0AH/80V |
| Power | 1.6KW | 4.0KW | 3.5KW |
| Blade Hole Diameter | 22.23mm | 25.4mm | 22.23mm |
| Blade Dimensions | 260mm | 350mm | 350mm |
| Cutting Depth | 108mm | 125mm | 125mm |
| Net Weight(Blade not included) | 5.8kg | 10.3kg | 12.5kg |
| Gross Weight | 6.5kg | / | 13.5kg |

**Prezentuar ne ofertë nga OE i rekomanduar, të dhënat për diskun janë përshtatur në harmoni më kërkesat e AK – përveq që nuk është plotësuar kriteri është bërë manipulim i të dhënave të paraqitura në katalog.**

## CIRCULAR METAL CUTTING SAW WITH BATTERY

Professional circular saw for firefighters, designed for heavy-duty work and emergency interventions, with an ergonomic handle and IP45 protection rating.
Saw blade: 12" (300 mm / 3.5 mm / 20 mm).
Suitable for operation in temperatures from -10°C to -40°C.
Accessories supplied with the saw
1 x saw blade (diamond disc)
1 x battery and charger

The saw is manufactured in compliance with EN 55014-1, EN 55014-2, EN 60745-1, EN 60745-2-22, 2011/65/EU, 2006/42/EC, 2014/30/EU, 2000/14/EC, ISQ 19432, the Electromagnetic Compatibility Regulations 2016, and the Restriction of Hazardous Substances Regulations for Electrical and Electronic Equipment, in accordance with EU standards
Manufactured for the European market.



### ▼ SPECIFICATIONS

| PROJECT | PARAMETERS | PROJECT | PARAMETERS |
|---|---|---|---|
| Rated voltage | 80V | Maximum cutting depth | 125mm |
| Power consumption | 4KW | Battery | Lithium-ion |
| Mximum water supply pressure | 5bar | Sound pressure | 2dB(A) |
| Measured vibration level | 2.8m/s | Minimum water flow | 0.6L/min |

Pajisja nuk plotëson kriterin për panel kontroll (Control Panel), nuk e plotëson kërkesën për nivelin e presionit të zërit.

**Pretendimi Ankimor Nr. 8. Poz. 2. Mospërmbushjet**

Bazuar në foton e prezentuar nga OE dhe disa nga të dhënat teknike bazuar të cilat kemi bërë konstatimet tona duke bërë krahasimin e tyre me të dhënat në katalogun zyrtar të prodhuesit.

**Katalogu i prodhuesit Odetools**



Chainsaw 372

| | |
|---|---|
| | 12050241/ 12050240/12050093 |
| | Two-stroke |
| | 70.7cc |
| | 4.1kW |
| | 2700rpm |
| | 13000rpm |
| | 770ml |
| : chain) | 6.23kg(Without guide plate chain) |
| | 500/558/609mm |



**Oferta e OE-së së rekomanduar:**

ODETOOLS

## RESCUE CHAINSAW FOR CUTTING ROOFING SHEETS

Professional rescue chainsaw for firefighters with an additional large handle for easier start-up with gloves,
another handle for quick and easy adjustment of cutting depth depth limiter for controlled cuts in channels.
The chainsaw is certified and tested according to the above standards
Sound pressure level measured according to ISO 22868: 106–109 dB(A)
The chainsaw is manufactured in compliance with ISO 7293, 11681, 2011/65/EU, 2006/42/EC, 2014/30/EU, 2000/14/EC, 2002/44/EC, EN 55012, EN 61000□6□1, ISO 9207 standards
**Accessories supplied with the chainsaw**
1 x guide bar (spate)
1 x chain
Manufactured for the European market.



### SPECIFICATIONS

| PROJECT | PARAMETERS |
|---|---|
| Moror power | 4.1 kW |
| Engine speed | 13,000 rpm |
| Displacement | 70.7 cm³ |
| Fuel type | Gasoline with emissions not exceeding 711 g/kWh |
| Fuel tank capacity | 0.77L |
| The chainsaw is equipped with a carbide chain suitable for cutting resistant materials and a 50 cm guide bar. | |

**Së pari një motorsharrë për prerje të llamarinës e dedikuar për ndërhyrje emergjente nuk i ngjan aspak një modeli si ky dhe së dyti nuk posedon as në 50% kërkesat që AK ka kërkuar.**

- Është kërkuar që motorsharra të jetë me zinxhirë që janë karbidi, material i cili bënë prerjen e materialeve më rezistente ndërsa është ofertuar model motrosharrë me zinxhir të llojit Plate. Në katalogun zyrtar të prodhuesit kemi vënë hijezimin me të verdhë aty ku tregohet zinxhir i shpatës , kjo është arsyeja që operatori i rekomanduar ka fshehur modelet dhe ka paraqitur të dhëna që janë përshkrim nga paramasa. Po ti referoheni ofertës së operatorit do të vëreni kopijimin e tekstit nga paramasa të përkthyer në anglisht dhe të vendosur poshtë modelit / foto.

  **Ndryshimet janë substanciale.**

**Carbide chain**

- Ka dhëmbë prerës të veshur ose të përforcuar me **karbid tungsteni (tungsten carbide)**.
- Qëndron shumë më gjatë pa u mpakur.
- Pretë materiale më të forta,

**Plate chain**

- Zakonisht është zinxhir standard prej çeliku me pllaka (plates) lidhëse.
- Përshtatet për prerje normale të drurit të pastër.
- Konsumohet më shpejt se zinxhiri me karbid.

- **Emetimi i gazit është një përshkrim, nuk plotëson kriterin e përcaktuar,**
- **Modeli nuk e plotëson kërkesën e AK për dorezë e cila mundëson rregullim të shpejt dhe të lehtë të kufizimit të thellësisë së prerjes për ekzekutim të prerjeve, shih foton si më poshtë e cila tregon paraqet se si duhet një dorezë e tillë.**



**Rregullimi / kufizmi i thellësisë së prerjeve është mëse i domosdoshëm në situata emergjente, një pamundësi për të mospërcaktuar ekzekutimet mund të shkaktojë cenim të sigurisë së përgjithshme për personin që punon me të,dhe për personat apo objektet që synohet të shpëtohen.**

- **Nuk plotëson kriterin për shpejtësin e zinxhirit,**
- **Nuk plotëson kërkesën pëe nivelin e zhurmës (në këtë parametër është bërë kopjimi nga kërkesa e specifikimeve AK).**

**Pretendimi Ankimor Nr. 9. Poz. 3. Mospërmbushjet**

Në katalogun zyrtarë të prodhuesit ODE TECHNOLOGY nuk bënë pjesë pajisja Ajërfryrëse portative për fikjen e zjarreve fushore – malore. Që kjo dhe disa nga pozicionet tjera nuk janë pjesë e gamës që kjo kompani prodhon është konfirmuar nga vet kompania në fjalë.

Prandaj, konstatojmë që është vendosur në katalog një pajisje e cila nuk përmbush kërkesat e AK – pa emër / pa model dhe kjo ngritë dyshimet për papërgjegjshmëri të të gjitha aspekteve.

**Prezentuar nga operatori i rekomanduar:**




**Pra, pikë për pike është bërë kopjimi i kritereve teknike të këtij pozicioni, vijon:**

| | | | |
|---|---|---|---|
| 3 | **AJERFRYRESE PORTATIVE PER FIKJEN E ZJARREVE FUSHORE - MALORE**<br><br>Ajerfryrëse portative (benzin) profesionale per zjarrfikes me sistem anti dridhje Forca fryrese : ≥32 N testuar sipas ANSI B175.2<br><br>Fuqia e motorit 3.8-5.7bhp / min 2500rpm / 60.00cc - 80.00cc<br>Rezervuari i derivatit 1.2 – 2.2 l | copë | 100 |

| | | | |
|---|---|---|---|
| | Niveli i fuqisë së zhurmës Lw sipas DIN EN 22868:2011 105-107 dB(A)<br>Niveli i presionit të zërit ne distance 15 m 75 dB(A)<br><br>Pesha e perafert 10.1kg, Emetimi I gazit 790-805 g/kWh<br>Shkalla maksimale e rrjedhjes së ajrit pa montim të tubit të fryrjes min 1380-2040m3/h<br><br>Shpejtësia e ajrit (velociteti) 104-108m/s<br>Ajerfryresja te jete e prodhuar sipas 2011/65/EU, 2006/42/EC, 2014/30/EU, 2000/14/EC EN ISO 12100, EN 15503, EN 55012, EN 61000, ISO 11094 , | | |

Pra, është kopjuar edhe njësia matëse e fuqisë së motorit "bhp" që është njësi e cila nuk aplikohet asnjëherë në pajisjet kineze. Të dhënat tjera janë manipuluar sërish duke u përcaktuar brenda intervalit të lejuar nga AK , e njëjta vlen edhe për standardet e aplikuara pasi nuk është ofruar asnjë dëshmi për këtë.

**Pretendimi Ankimor Nr. 10. Poz. 4. Mospërmbushjet**

Bazuar në katalogun zyrtar të prodhuesit ODE TECHNOLOGY dhe website zyrtarë kompanisë nuk figuron asnjë pajisje e cila i referohet fotografisë së prezentuar në ofertën e operatorit të rekomanduar. Edhe për këtë pozicion nuk është ofruar modeli / emërtimi i pajisjes ndërsa disa prej parametrave janë një kopje e përshtatur nga paramasa ndonëse si pajisje nuk e plotëson ndër të tjera fuqinë, zhvendosjen, rpm dhe / apo ISO 7293.

**Pretendimi Ankimor Nr. 11. Poz. 5. Mospërmbushjet**

**Modeli bazuar në foton e bashkëngjitur në ofertën e operatorit të rekomanduar i referohet modelit**

Lithium-Powered Chain Saw JIFI603

| | |
|---|---|
| Model Number | 12050140/12050214 |
| Battery Voltage | 42V |
| Motor Power | 2800W |
| No-Load Speed | 4600r/min |
| Guide Bar Length | 16" -18" |
| Cutting Diameter | 405mm |
| Voltage | 36V-72VCompatible |
| Speed | 7200r/m1n |
| Guide Bar Length (inches) | 405mm16 inch/450mm18 inch |
| Weight | 2.75kg(Batteries not included) |




Ky model nuk plotëson kërkesat për shkallën mbrojtëse IPX ndonëse në ofertën e dërguar është ëbrë përshkrimi i shkallës mbrojtëse IP44 por që katalogu i prodhuesit nuk e tregon këtë. Shkalla mbrojtëse është një faktor shumë i rëndësishëm i cili zë vend në secilin specifikacion teknik të prodhuesit. Për këtë pozicion niveli i garantuar i fuqisë së zhurmës është përshkruar në intervalet e përcaktuar në LOT 2, një pajisje nuk mund ti referohet një intervali të tillë, është parametër teknik fiks i cili ipet, mund të jetë i ndryshëm nga i garantuar në të matur por gjithsesi është një vlerë e jo një interval vlerash. Pajisja e ofertuar në këtë pozicion nuk i referohet kategorisë së produkteve rescue të prodhuesit, është një pajisje më shumë që plotëson gamën e tyre por jo e kategorizuar, si e tillë nuk është pjesë e certifikimit për sistemin e menaxhimit të kualitetit dhe të deklaratës së konfirmitetit.

**Pretendimi Ankimor Nr. 12. Poz. 6 deri në 16. Mospërmbushjet**

Artikujt e ofertuar nga Pozicionet 6 deri në 16 janë modele që janë paraqitur nga operatori i rekomanduar për kontratë të cilat fillojnë dhe mbarojnë në renditje të njëjtë sipas kërkesave të autoritetit kontraktues. Një teknik e tillë e të vepruarit tregon saktë dhe qartë tendecën manipulative për të hamendësuar autoritetin në vlerësimin e ofertave, Pretendim për të qenë të përgjegjshëm. Nuk pajtohemi me mënyrën se si ka vepruar autoriteti kontraktues në një aktivitet kaq të rëndësishëm për të. Një aktivitet si ky kërkon ekzaminim dhe verifikim të saktë të të dhënave në të kundërtën gjithsecili do të mund të dërgonte ofertë me të dhëna të pasakta dhe të punuara / mbishkruara konform kërkesës së autoritetit. Ne grupi i operatorëve ekonomik, të dyja të specializuara në fushën e pajisjeve / veglave të punës nga ato më të rëndomta deri tek niveli i katëgorisë profesionale dedikuar emergjencave, të dyja kompani që kanë realizuar me sukses kontrata nuk mund të mbyllim sytë para një diskriminimi të tillë, të padrejtë dhe plotësisht në anësi/favor të një operatori dhe në diskriminim të një oferte të përgjegjshme në cdo aspekt të kërkesave të autoritetit kontraktues.

Pozicioni Nr.8. Mjet Hyrjeje me Forcë, Huligan

- Është kërkuar të jetë me gjatësi maksimale 770mm dhe të jetë i farkëtuar nga celiku i aliazhuar me cilësi të lartë dhe trajtuar në nxehtësi për forcë,
- Është ofruar me të dhëna të përshtatura (foto 1) pasi ky model në katalogun e prodhuesit plotëson kërkesat si (foto 2):

Foto 1:




Foto 2:




**Që gjatësia e pajisjes mos të kaloj nivelin prej 770mm nuk është kërkesë e rastësishme e vendosur nga AK, një mjet si ky brenda këtij intervali dhe standardeve që përcaktojnë nivelet e gjatësisë për mjetë të tilla është më lehtë i përdorshëm, nuk krijon lodhje për përdoruesin dhe është më i sigurt gjatë punës me të.**
**760 mm**: më i manovrueshëm, kontroll më i mirë dhe zakonisht më pak rrezik për dëmtime të panevojshme.
Theksojmë që tendenca për të fshehur gjurmët për modelin konkret dhe manipulimi i të dhënave të prezentuara janë shkelje e rëndë e bërë nga ana e operatorit ekonomik. Në këtë pozicion nuk është plotësuar për materialin e kërkuar, është material "forged" i farkëtuar por që nuk përfshin trajtimin farkëtim nga celik i aliazhuar me cilësi të lartë dhe trajtuar në nxehtësi. Në terminologjin prodhuese këto përbëjnë ndryshim evident andaj dhe cmimi i tyre në treg ndryshon njëri nga tjetri.

Pozicioni Nr.11. Lopatë mbledhëse e borës,

- Është kërkuar të ketë dorezën në formë të shkronjës D, ndërsa modeli i paraqitu ne foto shihet që nuk e ka dorezën sipas kërkesës. Në këtë pozicion si duket operatura nuk e ka vënë re sigurt modelin në foto i cili është në kundërshtim me pjesën / përmbajten tekstuale të modelit e cila edhe në këtë pikë është kopjim nga kërkesat.



Baza e standadeve të kërkuara të jenë pjesë e aplikuar në procesin e prodhimit janë përshkruar aty ku AK ka kërkuar, një gjë e tillë e padëshmuar është në kundërshtim me praktikat e punës dhe procedurave në një aktivitet prokurimi. Në treg ekzistojnë prodhues të ndryshëm që zbatojnë standarde të tilla në procesin e prodhimit por të gjitha mbajnë një emër modeli apo një shifër artikulli e cila është e vendosur në dokumentet zyrtare të prodhuesit. Në mungesë të secilës pikë referuese, në tendencë për të ikur nga cfarë në të vërtetë plotësojnë modelet e ofertuara është manipulim. Për më tepër në kërkimet dhe kontaktet që kemi bërë me prodhues të ndryshëm pamjet nga fotografit të vendosura në këtë ofertë nuk janë pjesë e brendit ODETOOLS – Ode Technology, ndërsa të gjitha këto janë paraqitur si ODETOOLS.

Pozicioni Nr.13. Cekan L

Është ofertuar nën brendin ODETOOLS cekan i cili është me dorezë Antislip por nuk është SoftGrip apo e ndonjë emërtimi tjetër i cili i referohet kategorisë së materialit të kërkuar. Më poshtë po bashkëngjesim foto të modelit me detaje teknike







Një cekan L – Profesional me peshë prej 0.25kg është i lehtë për tu bartur por për të kryer punë nuk është aspak i kategorisë profesionale.

Pozicioni Nr.15. THIKE shpetimi dedikuar per nderhyrje emergjente

- ODE TECHNOLOGY nuk e prodhon këtë kategori të artikujve / mjeteve të shpëtimit,
- Pamja e prezentuar si foto në ofertën e dërguar është foto e marr nga interneti së cilës i është bashkëngjitur përshkrimi për disa prej të dhënave apo parametrave teknik të kërkuar nga autoriteti,
- Vërehet forma se si të dhënat për pajisjen janë paraqitur në ofertë, disa prej tyre nuk përmbajn vlerën e saktë por janë pëshkruar sipas "minimumit" të lejuar nga AK,

- **Është kërkuar:**

Lartësia: 17-25 mm,
Gjatësia: 100-120 mm,
Gjerësia: 25-35 mm
Pesha: 140-170 g

- **Është ofruar:**

▼ DIMENSIONS

| | |
|---|---|
| Width: | 35mm |
| Weight | 170g |
| Length | 117mm |
| Height | Ø10 mm |

**Marr nga oferta e operatorit të rekomanduar,**

**Konstatojmë përmbajte të kopjuar nga paramase në renditje të njëpasnjëshme. Nga tërësia e përmbajtes vërejm që ka mbetur pa u përshtatur / kopjuar vetëm kërkesa** Thyes dritaresh trashësia min 2,20 mm, diametri i shpimit 3,60 mm, fortësia 56.5 HRC, unaza çelësi, diametri ø10, fortësi 56 HRC
Të gjitha kriteret e vendosura nga AK të cilat kanë lejuar intervalin prej "min" si të tilla janë bartur ne ofertë, asnjëra prej tyre nuk ofron të dhënë parametrike ashtu sic duhet të ofroj një mjet si ky.

ODETOOLS

EMERGENCY RESCUE KNIFE

Pocket knife for firefighters which include at minimum: large folding blade, screwdriver, window breaker (movable)
Strong Can/Bottle Opener with: Bottle Opener;Wire Remover
Punch, pusher, seatbelt cutter, key, pliers, toothpick, saw disk for shatterproof glass (movable), luminescent handle, nylon cord, nylon pouch (knife holder)
The knife have a locking blade for one-hand opening, thickness 2.45 mm
The knife have a drilling diameter 3.13 mm and hardness 55.5 HRC *, δ = 0.5 HRC
**Strong screwdriver min 6.9 mm, drilling diameter min 3.00 mm, hardness 54.0 HRC**
Resistant glass disk blade thickness 2.43 mm, slot min 4.59 mm, hardness 54 HRC
Manufactured for the European market.



▼ DIMENSIONS

| | |
|---|---|
| Width: | 35mm |
| Weight | 170g |
| Length | 117mm |
| Height | Ø10 mm |

- Është kërkuar që mjeti të jetë i prodhuar konform direktivave 2002/96/EC dhe 2004/108/EC, nuk janë direktiva që plotëson mjeti me të cilin OE ka pretenduar të ofertojë ashtu sic nuk plotëson edhe specifikat tjera teknike të prezentuara, në rast se do të përmbushte atëherë do të vendoste specifikacionin teknik përkatës.

Pozicioni Nr.16. Sepate profesionale per zjarrfikes

- Është kërkuar sëpatë e prodhuar konform DIN 14924, ODE TECHNOLOGY nuk është e certifikuar me këtë standard.

Kompanit të cilat prodhojnë sëpata të dedikuara për zjarrfikës dhe janë të certifikuara më ISO DIN 14924 janë ndër të tjera: Donges GmbH & Co. KG, Prandi, Polas.

Për më tepër operatori i rekomanduar nuk ka ofruar asnjë dëshmi se modeli plotëson kërkesën e autoritetit përveq mbishkrimit në

secilin prej pozicioneve që pajisjet janë të prodhuara për tregun europian. Nisur nga fakti që kjo ofertë përmban parregullësi të shumta, përshtatje për tu dukur të përgjegjshëm vërteton konstatimet / bindjet tona që nga të 16-tat pozicionet asnjërin prej tyre nuk e ka në përputhshmëri me kërkesat e autoritetit.

Autoriteti kontraktues refuzon pretendimet nga numer 5 deri ne 12 me arsyetimin se konform ligjit ka bere verifikimet duke kontaktuar prodhuesin Odetools per produktet dhe certifikimet dhe se sipas tyre permbajtja e katalogut dhe certifikatat jane konform jane per tregun europian jane pohuar si te mireqena nga prodhuesi.

Rekapitulim / kronologji

1. ISO 9001 eshte certifikate me te cilen eshte i pajisur ODE Technology por certifikimi mbulon pajisje te cilat nuk jane pjese e aktivitetit LOT 2 – Si dokument / certifikate nuk do te duhej te pranohej nga AK per kete jemi ankuar ne.
2. Deklarata e konfirmitetit ehte e vlefshme vetem per pajisjet hidraulike – e argumentuam me fakte qe te gjitha modelet e perfshira ne CE jane gershere hidraulike dhe asnjeri prej modeleve per te cilat eshte derguar oferta nuk eshte pjese e deklarates. Kjo nenkupton qe per tregun europian prodhuesi ODE Technology i ka vetem pajisjet hidraulike dhe nuk posedon certifikim per asnjerin prej pajisjeve pjese e LOT 2 per te cilin ne kemi derguar kerkesen per rishqyrtim dhe po e dergojme kete ankese sot. Autoriteti kontraktues dhe secili nga palet ne kete aktivitet eshte ne dijeni qe deklarata e konfirmitetit apo certifikimi per te permbushur standardet per tregun europian i referohet modelet andaj deklarata e konfirmitet nuk mund te pranohet per kete aktivitet. Citojme nuk e kontestojme dokumentin per produktet te cilave u referohet, e kontestojme dhe nuk e pranojme si dokument per pajisjet te cilat jane pjese e Lot 2 perderisa asnjeri nga modelet nuk eshte i perfshire aty,
3. Certifikate ekzaminimi qe pajisja eshte e testuar, eshte ky dokument i ODE Techonogy eshte i papranueshem per LOT 2 pra aktivitetin per te cilin ne kemi ofertuar dhe po ankohemi. Dokumenti i derguar me oferten i operatorit te rekomanduar i referohet pajisjeve hidraulike te cilat nuk jane pjese e ketij aktiviteti. Citojme qe si dokument eshte i paprapnueshem dhe eshte JO Relevant per aktivitetin si i tille eshte i pavlefshem dhe eshte mospermbushje nga ana e operatorit ekonomik.
4. Autoriteti ne pergjigjjen e dhene ne refuzimin e kerkeses sone nga ngutia per te mos analizuar faktet tona dhe permbajtjen e kerkeses bene gabime si eshte data 08.05.2025:


Thank you in advance for your cooperation, and we look forward to your response.

Please find the attached documents for your review.

Best regards !

**Me datën 08.05.2025 kemi pranuar njoftimin me shkrim nga ana e prodhuesit sipas Autorizimit prodhuesi ODETOOLS përkatësisht prodhuesit kinez ODE TECHNOLOGY i cili ka konstatuar me sa vijon:**

<karenlee@ode119.com>

Reply | Reply All | Forward

KATALOGU LOTO 2_compressed.pdf

AUTHORIZATION Lot 2 – Runway shpk.pdf

MANUFACTURER'S AUTHORIZATION Lot 4(1).pdf

KATLOGO LOTO 4 (1)_compressed.pdf

Caution! This message was sent from outside your organization.

Dear Bajrami,

Nice to meet you.

This is Karen from ODE.

- We hereby officially inform you that all submitted documentation, including the catalogs of the equipment of our brand/manufacturer ODETOOLS, as well as the authorization documents, have been issued by our company for "RUNWAY SHPK" and "SABIT MAKIQI B.I (A&V COLLECTION)".
- These are the only official partners authorized for the sale of our brand in Kosovo and the region.

5. Pamjet nga website te bashkengjitura ne vendimin mbi refuzimin e kerkeses per rishqyrtim tregojne per nje nivel me te avancuar manipulimi i cili si duke po jep efektin e duhur tek autoriteti kontraktues i cili vazhdon te mbaje fuqi vendimin e dates 04 qershor ’26 per operator te papergjegjshem ekonomik,

Ne, si grup operatoresh ekonomik nga momentin i qasjes ne dokumentacionin e operatorit te rekomanduar kemi filluar me analizen e ofertes se toj qofte ajo teknike apo profesionale. I kemi konstatuar mospermbushjet dhe tendencen andaj kemi kontaktuar direkt fabriken, njeri prej tyre nuk ishte i kujdesshem sa Karen Lee, ishte Jessica Hu ishte ajo qe dergoi katalogun dhe pohoi se tere gama qe ata prodhojne eshte e perfshire ne katalogun 2026, linkun e se cilit e kemi bashkengjitur ne ankese. Komunikimin e kemi

permes telefonit dhe numrat zyrtar te Ode Technology te cilet figurojne ne website te tyre,

6. Ëebiste i prodhuesit eshte bere perditesuar duke shtuar qe ne kreun e pajisjeve / faqet e para menjehere sapo te kesh hyre ne kategorin RESCUE. Kete e kemi kuptuar pasi kemi pranuar vendimin mbi refuzimin e kerkeses per rishqyrtim ku ishin te vendosura pamje nga website i Odetools.

Me plotepergjegjesi themi qe nga dita e premte 04 qershor ‘26 deri me daten 9 qershor ’26 kur kemi derguar kerkesen per rishqyrtim website nuk i ka patur te perfshire artikujt per te cilet ne kemi ngritur pretendimet tona, me pranimin e vendimin kemi konstatuar ndryshimet e bere.

Qe kemi te drejt ne pretendimet tone, ne mospranimin e vendimit te dates 4 qershor ‘ 26 dhe ate te date 11 qershor ’26, qe oferta eshte teresisht manipuluese e tregojne faktet si me poshte:




date 11.06.2026




date 11.06.2026




date 11.06.2026




date 11.06.2026



date 11.06.2026

Njejte eshte paraqitja ne website me date 19.06.2026 e njejte edhe sot me date 22.06.2026 por qe ne shume pika vigjilenca i ka tradhetuar dhe nuk ishin aq te kujdesshem sa per te kamufluar te gjitha gjerat.

Ne vijim faktet nje nga nje te cilat tregojne mashtrimin / tendecen per manipulim

1. Sopatat – emertimi EMERGENCY RESCUE KNIFE

2. Thike shpetimi – Firefighter Axe,




3. Poz.10. Lopatë palosëse e dhembezuar
4. Eshte kerkuar lopate palosese e dhembezuar – fotoja nga website tregon qe lopata nuk eshte e dhembezuar ne njeren ndersa detajet teknike jane bartur sic jane paraqitur ne katalogun e ofertuesit te rekomanduar madje edhe

me leshime qe tregojne njesine matese te peshes “z” nuk eshte njesi matese, keshtu eshte paraqitur edhe katalogun e RUNWAY.







5. Poz.16.SEPATE PROFESIONALE PER ZJARRFIKES - permbajtja teknike eshte Poz.8. Mjet Hyrjeje me Forcë, Huligan




6. Poz.8. Mjet Hyrjeje me Forcë, Huligan - permbajtja teknike nuk ka te beje me huligan, si duket nga ngutia u jane nderruar vendet e specifikimeve teknike te njeritme tjetrin pozicion




Eshte ofertuar me katalogun e RUNWAY

## FORCE ENTRY TOOL, HALLIGAN



The head and claws is forged from high-quality alloy steel and heat-treated for strength.

The shaft is long, sharp, conical, and curved to fit a lock or door jamb.

Maximum length: 770 mm

Manufactured for the European market.

7. THIKE shpëtimi i dedikuar per nderhyrje emergjente – i referohet thike shpetimi ndersa pamje e nenvizuar tregon tjeter gje:

**Product Description**



Standard-setting firefighter's pick-head axe. Drop-forged high-carbon steel head with a razor-sharp cutting blade on one end and a heavy piercing pick on the other. Features a high-visibility, flame-retardant, non-conductive insulated fiberglass handle designed to protect operators against electrical hazards.

- **Application:** Structural ventilation, cutting through wooden barriers, roof chopping, and overhaul operations.
- **Specifications:**

Pocket knife for firefighters which include at minimum: large folding blade, screwdriver, window breaker (movable)

Strong Can Bottle Opener with: Bottle Opener;Wire Remover

Punch, pusher, seat belt cutler, key, pliers, toothpick, saw disk for shatterproof glass (movable), luminescent handle nylon cord, nylon pouch (knife holder)

The knife have a locking blade for one-hand opening, thickness 2.45 mm

The knife have a drilling diameter 3.13 mm and hardness 55.5 HRC *, δ = 0.5 HRC

Strong screwdriver min 6.9 mm, drilling diameter min 3.00 mm, hardness 54.0 HRC

Resistant glass disk blade thickness 2.43 mm, slot min 4.59 mm, hardness 54 HRC

Manufactured for the European market.

Te dhenat teknike qe tregojn parametra fiks jane vendosur ne minimume ashtu sic ishte kerkesa ne FDT, nje gje e tille nuk mund te konsiderohet e pranueshme, sa nuk mund te jete i pranueshem nje katalog me vlera te dhena teknike ne kete format nuk mund te konsiderohet i pranueshem apo element vertetesie nje mashtrim i tille i cili perfshin te 16tat pozicione.

8. Poz.3. AJERFRYRESE PORTATIVE PER FIKJEN E ZJARREVE FUSHORE - MALORE - nuk tregon asgje website, si eshte bere vleresimi per pajisje te cilat jane pershkrime nga paramasa, nuk dihet kush eshte prodhuesi, nuk kane model fare eshte nje gje e papranueshme dhe nje diskriminim i madh qe i eshte bere ofertes sone si grup ekonomik. Kjo tregon vetem pamjen nga website sot pasi mospermbushjen teknike e kemi paraqitur ne pretendimet me larte.




9. Poz.11 Lopatë mbledhese për borë  ne katalog eshte ofertuar si model qe nuk permbush kerkesen per te patur dorezen ne forme te shkronjes D, ate model nuk e kemi hasur as ne katalogun e operatorit te rekomanduar, as ne katalogun zyrtar te kompanise dhe si i tille eshte harruar te shtohen ne website.
10. Poz.5. perveq qe eshte nje pershtatje e kerkesave nga specifikacioni teknik i FDT, nese i referohesh website te cilen nder te tjera autoriteti e konsideron te mireqene per vertetesi tregon qe motorsharra eshte elekrike fillimisht e mandej paraqet detajet e baterise, si pajisje motorsharre ose mund te jete elektrike apo me bateri por te dyja nuk mund ti kete. Cfare ekzaminimi i ofertes eshte bere kur autoriteti nuk din as cfare do te marre ndersa vazhdon e rekomandon te pergjegjshem operator te tille.
11. Poz.1. katalogu zyrtar i prodhuesit tregon mospermbushje, katalogu i operatorit eshte i pershtatur sipas kerkeses se FDT , ndersa nese i referohesh website atehere modeli ne foto eshte model tjeter nga ai qe eshte derguar ne katalogun e RUNWAY.

    Shembull:

Katalogu zyrtar ODETOOLS




Katalogu i RUNWAY

Restriction of Hazardous Substances Regulations for Electrical and Electronic Equipment, in accordance with EU standards

Manufactured for the European market.



**Website**



**Cordless Battery Concrete Cutting Saw for Construction**

The Professional Circular Saw for Firefighters is engineered for dema emergency scenarios and heavy-duty applications. Designed to ope reliably in extreme conditions, this saw features an ergonomic hand optimal grip and IP45 protection against dust and water ingress. Its diamond blade (300 mm / 3.5 mm / 20 mm) ensures precise and effic cutting performance, making it ideal for rescue operations, fire interventions, and industrial applications.

Quantity: 1

12. Poz.5. Min 2.8kW ndersa input power 3KV, njeri parameter ne minimum ndersa tjeter fiks, nuk tregon konsistence, kjo shton papergjegjshmerin dhe manipulimin.

**Product Description**



This portable electric chainsaw is equipped with high-capacity lithium battery and high-efficiency motor, delivering stable power and long working time. It features fast cutting speed, low noise, ergonomic handle and safety lock. Ideal for tree pruning, wood cutting, garden maintenance and household use.

- **Specifications:**
  Professional chainsaw for firefighters with battery-powered chain for cutting wood 42V- Lithium-ion
  The saw has a rubber handle and anti-vibration system IP44
  Output power min 2.8 kW
  **Input power:** 3 KV
  **Net weight :** 4.5 kg Bar 45 cm with minimum 10 teeth

13.Ne website per te njejten pajisje jane vendosur pamje te ndryshe, pajisja e cila eshte ne katalogun e RUNWAY edhe website njejte mbane te fshehur mbi shkrimet.




**Përmbledhje:**

Nga sic është argumentuar si më lartë në secilën pikë apo pretendim ankimor ne si grup i operatorëve ekonomik kemi ofruar fakte të bazuara. Nuk pranojmë vendimin për operator të rekomanduar i cili është plotësisht i papërgjegjshëm. Shkeljet janë evidente edhe nga ana e autoritetit kontraktues të cilët vetëm sa kanë shtuar parregullsit me vendimin e dhënë. **Per manipulimin e ODETOOLS si brend apo ODE TECHNOLOGY si prodhues, departamenti ligjor i prodhuesit FISKARS ka filluar procedurat ligjore per dergimin e "Leter per nderprerje dhe heqje dore" ne anglisht "Cease and Desist Letter" per veprimet e paligjshme dhe te paautorizuara per perdorimin / shkeljen e markes tregtare.** Rivlerësimi i aktivitetit të prokurimit të bëhet në harmoni me Neni 70. Standardet për Sigurimin e Cilësisë, ashtu sic janë kërkuar me dosje të tenderit.

Përfundimisht kërkojm vlerësim të drejt bazuar në LPP, kërkesat nga FDT, paramasa, sqarimet e dhëna dhe mbi te gjitha per nje vleresim dhe ekzaminim te drejt te ofertes se operatorit te rekomanduar per kontrate pasi shkeljet janë evidente.

Pra, është shkelur Neni 59 Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahasimi i Tenderëve 1. Autoriteti kontraktues do të themeloi një Komision Vlerësues për ekzaminimin, vlerësimin dhe krahasimin e ofertave. 2. Autoriteti kontraktues mundet që me shkrim të kërkojë nga një tenderues që të sigurojë një sqarim me shkrim mbi cilindo nga aspektet e tenderit të tij, në mënyrë që të bëhet ekzaminimi, vlerësimi ose krahasimi i tenderëve. Asnjë ndryshim material dhe asnjë aspekt i tenderit nuk duhet të kërkohen ose pranohen nga autoriteti kontraktues ose të ofrohen nga një tenderues. 3. Autoriteti kontraktues do të përmirësojë gabimet në një tenderë të cilat janë tërësisht aritmetike, nëse gabimet e tilla zbulohen gjatë ekzaminimit të tenderëve. Autoriteti kontraktues menjëherë do t'i dërgojë të gjithë tenderueseve përkatës një njoftim me shkrim mbi ndryshimet e tilla. 4. Autoriteti kontraktues do të konsiderojë një tender si të përgjegjshëm vetëm nëse tenderi në fjalë është në përputhshmëri me të gjitha kërkesat e parashtruara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit. Pavarësisht nga e mëparshmja, autoriteti kontraktues mund të konsiderojë një tender si të përgjegjshëm nëse: (i) përmban vetëm gabime ose paqartësi të cilat mund të korrigjohen pa ndryshuar kushtin material apo aspekin e tenderit ne fjalë, ose (ii) përmban vetëm devijime të vogla që nuk mund të shkaktojnë ndryshime materiale ose devijime nga karakteristikat, kushtet, dhe kërkesat e tjera të parashtruara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit; me kusht që, çfarëdo devijimi i tillë të kuantifikohet, aq sa është e mundshme, dhe të merret parasysh gjatë vlerësimit dhe krahasimit të tenderëve.

8.2 "Kriteret e përshtatshmërisë" dhe "kërkesat minimale të kualifikimit" së bashku karakterizohen si "Kritere të Përzgjedhjes".

Kritere e Përzgjedhjes janë kërkesa që një OE duhet të përmbushë për tu konsideruar i kualifikuar për dhënie të kontratës publike dhe nisur nga këtu shihet qe eshte rekomanduar për kontratë operator ekonomik që nuk ka përmbushur as kërkesat minimale të vendosura në FDT . Nje shkelje qe duhet te diktonte refuzim/eliminim te ofertes menjeher.

Andaj duke u bazuar në tëra këto fakte konstatojmë shkeljen e bërë nga autoriteti kontraktues në këtë aktivitet prokurimi.

Bazuar në të gjitha dëshmitë dhe argumentet e lartëcekura vlerësojmë se ju ai autoritet kontraktues keni Shkelur ligjin e prokurimit publik, sipas të cilit, qëllimi i këtij Ligji është mes tjerash, cituar: "...të siguroj integritetin dhe përgjegjësinë e zyrtarëve publik, nëpunësve civil dhe personave të tjerë që kryejnë ose janë të përfshirë në një aktivitet të prokurimit duke kërkuar që, vendimet e individëve të tillë dhe baza ligjore e faktike për vendimet e tilla, të mos ndikohen nga interesat personale, të karakterizohet me jo-diskriminim dhe me një shkallë të lart të transparencës dhe, të jenë në përputhje me kërkesat procedurale dhe qenësore të këtij ligji" si duket në këtë rast nuk është zbatuar. Ndërsa lidhur me nenin 105, duke e pasur parasysh kërkesën e nenit 104, paragrafi 1, të Ligjit të cituar sipas të cilit, cituar: "Procedura e shqyrtimit të prokurimit do të zbatohet dhe realizohet në mënyrë të shpejtë, të drejtë dhe pa diskriminim, që ka për qëllim zgjidhjen e drejtë, të ligjshme dhe efektive të lëndës..." andaj ne kërkojmë nga AK si organi më i lartë në këtë rast të shqyrtojë ankesën tonë dhe të nxjerr vendim të drejtë të ligjshëm të bazuar mbi të tëra këto fakte teknike, administrative dhe ligjore per te percaktuar kerkesa ne harmoni me natyren e aktivitetit pa kufizike te skajshme – Aneks 1 Specifikimet Teknike te Detyrueshme.

Baza ligjore
Neni 1. Qëllimi
Neni 7. Barazia në Trajtim/ Jo-Diskriminimi
Neni 6. Ekonomiciteti dhe Efikasiteti
Neni 66 Përshtatshmëria Profesionale
Neni 69 Aftësia Teknike dhe/ose Profesionale
Neni 28. Specifikimet teknike
Neni 70. Standardet për Sigurimin e Cilësisë
Neni 59 Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahasimi i Tenderëve

Krejt në fund, kur kemi parasysh të gjitha faktet dhe dëshmitë që u përmendën më lartë, ju njoftojmë se nëse nuk anuloni njoftimin e vendimit te dates 04 qershor 2026 dhe nëse ju si AK nuk veproni konform dispozitave ligjore, ne nuk do të ndalemi me këtë kërkesë për rishqyrtim por do të vazhdojmë ME procedurat ligjore edhe në institucionet tjera administrative.

Duke u bazuar në dëshmitë dhe argumentet që u cekën më lartë, kërkojmë nga ju që të merrni:

**VENDIM**

**APROVOHET ANKESA e Grupit të OE KOMTEL PROJECT ENGINEERING SH.P.K. & BAJRA N.P.T.** si e bazuar,
**TE ANULOHET VENDIMI I** dates 04.06.2026 dhe lënda të kthehet në
**RISHQYRTIM** dhe gjatë rishqyrtimit, ekzaminimi, vlerësimi dhe krahasimi i ofertave të bëhet në harmoni me kërkesat e dosjes së tenderit, njoftimit për kontratë dhe konform dispozitave të LPP-së.

Nëse nuk merren parasysh faktet tona, ne jemi të detyruar të vazhdojmë procedurën ligjore në institucionet tjera kompetente.

**8. Dëmet materiale**

*Përshkruaj mënyrën se si shkelja e supozuar ka shkaktuar ose kërcënohet t'iu shkaktojë dëme materiale, ne rast se përfshini pretendime për kompensim.*

| |
|---|
| **Pamundësi e ushtrimit të veprimtarisë profesionale si dhe kosto në përgaditjen e ofertës.** |

**9. Lista e dokumenteve (dëshmive) të bashkangjitura**

*Nëse aplikohet, bashkëngjitni kërkesës dokumentet e renditura më poshtë:*

a) *një kopje të publikimit të "Njoftimit për Kontratë" apo "Njoftimit për Konkurs të Projektimit.*
b) *një kopje të publikimit për "Njoftimin e Dhënies së Kontratës" apo "Njoftimin për Rezultatet e Konkursit të Projektimit" apo "Njoftimit për Anulim".*
c) *një kopje të letrës së eliminimit të tenderuesit/kandidatit/ letrës se tenderuesit të pasuksesshëm/ letrës për mos para-kualifikim.*
d) *një kopje të procesverbalit të hapjes publike të tenderëve, nëse aplikohet.*